



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Informatikë Biznesi”

ofruar nga

Universiteti "Fan S.Noli", Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ana Ktona 

Dr. Blerta Leka (Moçka) 

Shtator / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: "Informatikë Biznesi"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: "Informatikë Biznesi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 402, datë 12.07.2018.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 51, datë 15.03.2022.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimit me kohë të plotë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 24 PAE / 5 PAK; 2023-2024 26 PAE / 5 PAK;; 2024-2025 24 PAE / 5 PAK;
18	Numri i studentëve:	2022-2023 19 studentë; 2023-2024 9 studentë; 2024-2025 19 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë u licencua me vendim VKM nr. 5 datë 07.01.1992 të Këshillit të Ministrave mbi Bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar ne vitin 1971. Universiteti i Korcës mban emrin zyrtar "Fan S. Noli, me vendim VKM Nr. 213, datë 24.05.1994.

Fakulteti i Ekonomisë është një nga katër njësitë kryesore të Universitetit "Fan S. Noli". Ky fakultet synon të arrijë standarde akademike dhe pajisjen e studenteve me dije dhe njohuri praktike të cilat do ti ndihmojnë ata të përballen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi" është pjesë e programeve të studimit të ciklit të parë të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë. Ky program studimi është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Nr. 402, datë 12.07.2018, për hapjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi" në Universitetin "Fan S. Noli".

Programi i studimeve Bachelor në "Informatikë Biznesi" ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit të Menaxhimit. Ky departament ka bashkëpunim te ngushtë me Departamentin e Informatikës të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, për ofrimin e programit të studimit. Ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e ekonomisë dhe informatikës.

Ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Studentët e këtij programi kanë mundësinë të zhvillojnë leksionet në ambiente komode, për sa i përket zhvillimit të leksionit, si dhe kanë akses në facilitete si biblioteka, laborator, etj.

Specifikojmë se studenti në këtë program studimi, sikurse edhe në çdo program tjetër studimi të ofruar në këtë institucion, është në qendër të vëmëndjes si për departamentin dhe për institucionin që e ofron këtë program. Lektorët janë të angazhuar dhe ofrojnë profesionalizëm dhe transparencë në punën e tyre.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit “Fan S. Noli”, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm.

Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë edhe gjatë vizitës në Fakultetin e Ekonomisë të zhvilluar në datat 5 dhe 6 Mars 2025 sipas një agjende të hartuar nga GVJ me asistencën e ASCAL.

Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ zhvilloi takime me: Dekanin e FE dhe Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit, me Zyrën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, stafin e Sekretarisë Mësimore si dhe studentët që ndjekin programin e studimit. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë IAL. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin objektivisht performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Prof. Dr. Ana Ktona** dhe **Dr. Blerta Leka (Moçka)**. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 25.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36/95 Prot, datë 25.07.2025. Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, njofton në ASCAL në datë 02.09.2025, nëpërmjet shkresës me Nr. 1510/1, Prot, datë 28.08.2025, “*Dërgohen komentet për draft raportin e vlerësimit të jashtëm Bachelor në Informatikë Biznesi*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Fan S. Noli” Korçë (referuar më poshtë si UNIKO) është institucion publik i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe të transferimit të dijeve të të tretëve. UNIKO është IAL që financohet nga shteti dhe burime të tjera të ligjshme. UNIKO, përbëhet nga katër fakultete/njësi kryesore, përkatësisht: 1. Fakulteti i Bujqësisë; 2. Fakulteti i Ekonomisë; 3. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë; 4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane; Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, GJV konstatoi se programi i studimit, Bachelor në “Informatikë Biznesi” është në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, që synojnë zhvillimin dhe konservimin e vlerave akademike kombëtare. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT ‘FAN S. NOLI’.pdf</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Qëllimi kryesor i UNIKO, Fakultetit të Ekonomisë (FE) dhe i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” që është pjesë në këto struktura është të ofrojë arsim të lartë, zhvillimin e dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe profesioneve të ligjshme. UNIKO ka për mision “të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social e kulturor në nivel rajonal e kombëtar”. Veprimtaria kërkimore-shkencore në UNIKO, zhvillohet në përputhje me nevojat zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Ajo synon t’u paraprijë dhe t’u japë përgjigjet sfidave të zhvillimit dhe të integritetit të vendit në strukturat evropiane, shfrytëzimit të



	qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjes së prodhimit vendas dhe njëkohësisht zgjerimit të llojshmërisë dhe të vëllimit të eksporteve, rritjes konkurrencës, etj. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDASHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” ofrohet në përshtatje me profilin dhe ekspertizën e njësisë kryesore FE, pjesë e të cilit është Departamenti i Menxhimit ku ofrohet ky program. Ky program studimi i oruar nga bshkëpunimi i ngusht midis dy fakulteteve të UNIKO Fakultetit të Ekonomisë dhe Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane nuk bie ndesh me interesat dhe strategjitë kombëtare të ekonomisë dhe zhvillimit të Arsimit të Lartë në vendin tonë. Nëpërmjet këtij program studimi synohet dhe mundësohet, përgatitja e specialistëve në fushën e menaxhimit të informacionit dhe informatikës. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Ky program integron parimet e Deklaratës së Bolonjës, si dhe eksperiencat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare si rezultat i angazhimit akademik dhe kërkimor të stafit të departamentit. Lëndët e planit mësimor janë të strukturuar sipas kategorive A-E, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM Nr. 185, datë 25.03.2021, duke respektuar balancën mes përmbajtjes teorike dhe aplikative, si dhe mes fushave të informatikës dhe menaxhimit të biznesit. <i>Referenca:</i>




	<i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 2.4 VKM Nr 41 datë 24/01/2018 I NDRYSHUAR.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga dokumenti i vënë në dispozicion nga IAL dhe nga vizitat në institucion, vihet re se ka një përputhshmëri midis fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore përgjegjëse të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi". Kjo arrihet fal bashkëpunimit të ngushtë që kanë dy departamentet të cilat e ofrojnë këtë program studimi nga dy fakultetet te UNIKO: Fakulteti i Ekonomisë nga Departamenti i Menaxhimit dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (Departamenti i Informatikës). <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi i ofruar nga bashkëpunimi i dy njësive bazë në Universitetin Fan Noli Korçë Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Informatikës është në përputhje me misionin dhe vlerat e këtyre dy njësive për kontributin në zhvillimin rajonal dhe kombëtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për programin Bachelor në "Informatikë Biznesi" dhe nga takimet me studentët dhe organet drejtuese, GVJ konstatoi se UNIKO ka hartuar dhe miratuar rregulloret e brendshme për mbarëvajtjen dhe



frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	funksionimin e njësive akademike dhe ndihmës-akademike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, janë përcaktuar qartë funksionet dhe detyrat e strukturave të brendshme si: përgjegjësi i departamentit, përgjegjësit e grupeve mësimore dhe kërkimore-shkencore, koordinatori i programit, si dhe stafi akademik i angazhuar në procesin mësimor dhe kërkimor. Ndërkohë, njësia kryesore – Fakulteti i Ekonomisë – në bashkëpunim të ngushtë me njësinë bazë UNIKO, mbikëqyr dhe siguron funksionimin efektiv të programit. Procesi i hartimit, organizimit dhe zhvillimit të programit realizohet në mënyrë të koordinuar dhe të integruar ndërmjet të gjitha strukturave përgjegjëse (drejtuese, akademike dhe administrative), duke mundësuar ndarjen e qartë të përgjegjësive dhe monitorimin e përhershëm të zbatimit të tij. Departamenti i Menaxhimit dhe Fakulteti i Ekonomisë kryejnë në mënyrë periodike analizën vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore, duke përfshirë vlerësimin e përmbajtjes dhe cilësisë së programit. Këto analiza janë të dokumentuara dhe të depozituara në sistemin DVV të ASCAL, duke siguruar transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, tabelave përmbledheës dhe nga RVB konstatohet se FE ka marrëveshje bashkëpunimi me 61 Universitet dhe institucione të tjera. Në të njëjtën kohë, për shkak të natyrës ndërdisiplinore të programit, në strukturën mësimore janë të integruara edhe disiplina nga fusha e informatikës, të cilat mbulohen nga Departamenti i Informatikës i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, përmes bashkëpunimit institucional të



vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	formalizuar ndërmjet njërive. Ky integrim siguron mbulim të plotë akademik dhe kërkimor në përputhje me objektivat e programit dhe kërkesat e tregut të punës. Lëndët e planit mësimor janë të strukturuar sipas kategorive A-E, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM Nr. 185, datë 25.03.2021, duke respektuar balancën mes përmbajtjes teorike dhe aplikative, si dhe mes fushave të informatikës dhe menaxhimit të biznesit. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.33 MARRËVESHJE INSTITUCIONALE.pdf</i> <i>Aneksi 1.34 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS FE DHE UNIVERSITETEVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA.pdf</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është një program i ciklit të parë, i organizuar në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, niveli 6, me 180 kredite (ECTS) dhe një kohëzgjatje normale prej tre viteve akademike. Ky program është i kodifikuar sipas kërkesave të VKM Nr. 310, datë 20.05.2022, si dhe i ndërtuar në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe evropiane për klasifikimin e programeve të studimit sipas fushave të arsimit. Pjesë e rëndësishme e programit të studimit për njohjen me tregun e punës është edhe praktika, e cila vlerësohet me 2 kredite. Për realizimin e saj Departamenti i Menaxhimit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 6 biznese private. Gjithashtu nga takimi me studentët një pjesë e tyre propozonin vetë biznesin ose institucionin ku do të realizonin praktiken mësimore. <i>Referenca:</i> <i>RVB BA IB.pdf</i> <i>Aneksi 1.35 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT DHE BIZNESIT PRIVAT.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e	Nga raporti i RVB dhe takimet në institucion me përgjegjësen e Departamentit të Menaxhimit dhe stafin akademik njësia bazë harton raporte vjetore për realizimin e praktikës profesionale rreth rezultateve të arritura nga studentët në këto praktika dhe përfitimit nga këto marrëveshje. Njësia kryesore dhe njësia bazë si njësi përgjegjëse për programin e studimit, në hartimin




bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	e raporteve analitike të përfitimeve nga këto marrëveshje bashkëpunimi, merr në konsideratë sugjerimet dhe propozimet e ekspertëve të fushës në funksion të përmirësimit dhe realizimit të objektivave të programit të studimit. Departamenti i Menaxhimit ka nënshkruar 6 marrëveshje bashkëpunimi me biznese privat në funksion të praktikës profesionale për studentët dhe aktivitet të tjera në funksion të realizimit të programit të studimit. <i>Referenca:</i> RVB BA IB.pdf Aneksi 1.35 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT DHE BIZNESIT PRIVAT.pdf Takimimi në institucion me drejtuesen e departamentit			
Konkluzione	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se FE si njësi kryesore dhe njësi bazë (Departamenti i Menaxhimit) kanë formalizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, ente publike dhe biznese private, në funksion të zhvillimit të procesit mësimor, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor. GVJ vlerëson se ky bashkëpunim ndërinstitucional dhe brenda njësi përbush në mënyrë të plotë standardin përkatës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve


Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është një program i ciklit të parë, i organizuar në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, niveli 6, me 180 kredite (ECTS) dhe një kohëzgjatje normale prej tre viteve akademike. Ai është i ndarë sipas veprimtarive formuese në pesë kategori (A-E), në përputhje me VKM Nr. 41/2018, të ndryshuar. Lëndët/modulet janë të organizuara në mënyrë të qartë, të detyrueshme dhe me zgjedhje, dhe përmbajnë një raport të balancuar ndërmjet përmbajtjes teorike, ndërdisiplinore dhe praktike.

Kreditet janë përcaktuar për çdo lëndë bazuar në ngarkesën mësimore në auditor si dhe në punën individuale të studentit, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Referuar të dhënave të kurrikulës dhe planit mësimor, ky program studimi përfshin 33 module, praktikën profesionale dhe mikrotezën. Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM Nr.41 të ndryshuar (shtojca 1, VKM 185/2021), dhe kategorizimi i lëndëve është si më poshtë:

Kate goria	Komponenti mësimor	Kërkesa ligjore	Kredite
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 lëndë)	15% – 20%	33/kredite / 18.3 %
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore (19 lëndë)	50% – 55%	97 /kredite/ 53.9%
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INT EGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (5 lëndë)	12–15% (kredite)	25 /kredite/ 13.9%
D	LËNDË PLOTËSUESE –(4 lëndë)	10-15%% (kredite)	10/kredite/ 10.0 %
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE (Mikroteza)	3–5% (kredite)	3.9 /kredite/ 10%

	* Totali 180 Kredite
	<i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi Bachelor në “Informatikë Biznesi” synon përgatitjen e studentëve me njohuri të përparuara teorike dhe praktike në fushën ndërdisiplinore të menaxhimit dhe informatikës. Objektivat formuese të programit fokusohen në zhvillimin e shprehive analitike, aftësive për zgjidhjen e problemeve, kompetencave teknologjike dhe menaxheriale, të domosdoshme për t’u përballur me sfida të tregut të punës dhe të ndërmarrjeve moderne. Përmes moduleve të fokusuara në programim, sisteme informacioni, ekonomi, financë dhe menaxhim biznesi, studentët pajisen me një formim të gjithanshëm që mundëson punësimin e tyre në një gamë të gjerë profesionale si analist biznesi, zhvillues softueri, specialist të IT-së në institucione financiare dhe kompani private, si dhe administratorë të sistemeve të informacionit. Plani mësimor i programit është i ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe përfshin: strukturën semestrale, ndarjen e moduleve sipas kategorive formuese (A–E), ngarkesën në kredite (ECTS), ndarjen e orëve në leksione, seminare, ushtrime, laboratore dhe projekte kursi. Përmbajtja dhe frekuentimi i lëndëve, periodhat e vlerësimit dhe mënyrat e kontrollit të njohurive janë të përcaktuara qartë dhe publikohen për studentët në faqen zyrtare të universitetit dhe në zyrat përkatëse. Për më tepër, Departamenti i Menaxhimit, në zbatim të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, kryen rishikimin dhe përditësimin vjetor të planit mësimor në përputhje me zhvillimet akademike dhe kërkesat e tregut të punës, duke



	siguruar që programi të mbetet bashkëkohor, i aplikueshëm dhe i orientuar drejt rezultateve të matshme në praktikë. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është i strukturuar qartë në pesë kategori veprimtarish formuese (A-E), në përputhje me VKM Nr. 41/2018, të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021. Lëndët janë të ndara në module të detyrueshme dhe me zgjedhje, me kredite të përcaktuara në bazë të ngarkesës mësimore në auditor dhe punës individuale të studentit. Sipas planit mësimor dhe kurrikulës, programi përfshin 33 module, praktikën profesionale dhe mikrotezën përmbyllëse. Ndarja e krediteve sipas kategorive është si më poshtë: • A (Lëndë Bazë): 33 kredite (18.3%); • B (Lëndë Karakterizuese): 97 kredite (53.9%); • C (Lëndë Ndërdisciplinore): 25 kredite (13.9%); • D (Lëndë Plotësuese): 18 kredite (10.0%); • E (Detyrime Përmbyllëse – Mikroteza): 7 kredite (3.9%); Të gjitha përqindjet janë brenda kufijve të përcaktuar nga kuadri ligjor, dhe struktura e programit pasqyron një ekuilibër të mirë midis njohurive teorike, aftësive teknike dhe përgatitjes praktike. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” parashikon në mënyrë të qartë zhvillimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Praktika profesionale është e vlerësuar me 2 kredite ECTS, dhe realizohet në vitin e tretë të studimeve, në bashkëpunim me institucione dhe biznese partnere, duke i



profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	mundësuar studentëve aplikimin e njohurive teorike në situata reale të punës. Detyrimi përmbyllës i programit është i strukturuar në formën e mikrotezës, sipas zgjedhjes së studentit dhe udhëzimeve të Departamentit dhe ka një ngarkesë prej 7 kreditesh ECTS, duke përfaqësuar përqindjen e përcaktuar në VKM-të përkatëse. Studentët kanë edhe një udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>aneksi 2.7 UDHËZUES - PUNIM DIPLOME.pdf</i> <i>Aneksi 1.34 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS FE DHE UNIVERSITETEVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA.pdf</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në DVV, përfshirë planin mësimor, kurrikulën dhe strukturën e programit Bachelor në "Informatikë Biznesi", GVJ konstaton se përmbajtja e tij është në linjë me programet e ngjashme të ofruara nga IAL të tjera në vend, si dhe në përputhje me standardet e përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (niveli 6). Struktura e programit, lëndët/modulet, shpërndarja e krediteve dhe ngarkesa mësimore janë të ndërtuara mbi një model të krahasueshëm me programe homologe brenda dhe jashtë vendit. Ngjashmëria e përmbajtjes arrin ose tejkalon prapun minimal prej 70%, duke siguruar një formim të qëndrueshëm dhe konkurrues për studentët në fushën ndërdisiplinore të informatikës dhe ekonomisë.

	<i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konfirmon se programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është një program i ciklit të parë, i referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KShK), me një kohëzgjatje normale prej tre viteve akademike (6 semestra) dhe me një ngarkesë totale prej 180 kreditesh ECTS, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” dhe aktet nënligjore përkatëse. Programi është hapur me urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nr. 402, datë 12.07.2018, dhe është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë me numër unik identifikimi KO4816221475, i lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Ky kod përdoret në diplomat e studentëve të diplomuar. Programi është shoqëruar me kodifikimin përkatës të lëndëve sipas sistemit ECTS, në përputhje me udhëzimet dhe klasifikimet e bëra publike nga MAS/ASCAL. <i>Referenca:</i> <i>Dokumentacionin në AMS:</i> <i>Urdhër Nr.402, datë 2018-07-12</i> <i>Urdhër Nr.51, datë 2022-03-15</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi “Informatikë Biznesi” ofrohet nga e njëjta IAL, Universiteti “Fan S. Noli” (UNIKO), dhe realizohet në bashkëpunim të ngushtë midis Departamentit të Menaxhimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Informatikës të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane.
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është organizuar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nënligjore kombëtare, duke ndjekur Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i>

	Struktura e tij e qartë, dhe bashkëpunimi institucional ndërfakultetesh sigurojnë një formim të gjithanshëm, ndërdisiplinor dhe konkurrues për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																											
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është Fakulteti i Ekonomisë (FE) në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë. Ky fakultet përbëhet nga tre departamente: • Departamenti i Menaxhimit; • Departamenti i Financë-Kontabilitetit; • Departamenti i Marketing-Turizëmit; Departamenti i Menaxhimit (DM) është njësia bazë përgjegjëse për programin Bachelor në “Informatikë Biznesi”. Referuar dokumentacionit shoqërues, për vitin akademik 2024–2025, Departamenti i Menaxhimit ofron gjithsej 4 (katër) programe studimi, të ndara sipas cikleve të mëposhtme: • 2 (dy) programe në ciklin e parë (Bachelor): “Menaxhim” dhe “Informatikë Biznesi”; • 1 (një) program në ciklin e dytë (Master Profesional në “Administrim Biznesi”); • 1 (një) program profesional dyvjeçar pas arsimit të mesëm: “Asistent Menaxher”; Departamenti i Menaxhimit përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>4</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr></table>	Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	4	-	4	-	4	-
Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025																							
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																						
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-																						
Prof. Asoc.	4	-	4	-	4	-																						




	Dr./PhD.	4	-	4	1	4	1
	Msc.	1	2	1	1	1	1
	Totali	9	2	9	2	9	2
Departamenti i Menaxhimit si njësi bazë dëshmon se ka kapacitetet e duhura akademike, mësimdhënëse dhe kërkimore për ofrimin cilësor të programit Bachelor në “Informatikë Biznesi”. Referuar shqyrtimit të CV-ve të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie, GVJ konstaton se fushat e tyre akademike dhe kërkimore janë në përputhje të plotë me specifikat e programit, me përmbajtjen dhe natyrën e moduleve që mbulojnë. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>RVB BA IB.pdf</i>							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga vizitat dhe takimet në institucion dhe referuar dokumentacionit të dorëzuar në DVV, konkretisht Tabelave përmbledhëse 1 dhe 2, rezulton se Departamenti i Menaxhimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin Bachelor në “Informatikë Biznesi”, ka të përfshirë në përbërjen e tij edhe 1 (një) anëtar si personel ndihmës akademik. Ky personel ndihmës akademik mbështet veprimtaritë mësimore dhe kërkimore të stafit akademik, veçanërisht në aspektet praktike dhe administrative të zbatimit të planit mësimor. Ajo luan një rol të rëndësishëm në organizimin dhe mbarvajtjen e laboratoreve dhe në ndjekjen e praktikave të studentëve, në funksion të realizimit të objektivave të programit dhe përmbushjes së standardeve të cilësisë. <i>Referenca:</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>RVB BA IB.pdf</i> <i>Takimet në institucion</i>						
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo	Departamenti i Menaxhimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin Bachelor në “Informatikë Biznesi”, ka emëruar një personel akademik në rolin e Koordinatorit të Programit të Studimit. Ky person është përgjegjës për ndjekjen e ecurisë,						

program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	zhvillimin e programit dhe koordinimin e praktikave profesionale, në përputhje me objektivat dhe standardet e përcaktuara për këtë program. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit janë të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit, Kreu II, Neni 9 (Aneksi II.10), dhe përfshijnë bashkëpunimin me drejtuesin e departamentit, stafin akademik dhe grupet mësimore, për garantimin e cilësisë në procesin mësimor dhe realizimin e praktikave profesionale. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDASHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.9 VENDIM I EMËRIMIT TË KOORDINATORIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDASHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti i Menaxhimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin Bachelor në "Informatikë Biznesi", përmbush kërkesat ligjore dhe standardet cilësore të parashikuara për këtë nivel studimi.</i> <i>Struktura organizative, përbërja dhe kualifikimi i stafit akademik, përfshirja e personelit ndihmës si dhe emërimi i koordinatorit të programit, dëshmojnë angazhim të plotë institucional për ofrimin dhe zhvillimin cilësor të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimeve Bachelor në “Informatikë Biznesi” ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit të Menaxhimit, si njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin “Fan S. Noli”. Ky program është ndërtuar për të përmbushur nevojat aktuale të tregut të punës dhe për të zhvilluar kompetenca ndërdisiplinore në fushat e menaxhimit dhe teknologjisë së informacionit. Për realizimin e suksesshëm të objektivave të programit, Departamenti i Menaxhimit bashkëpunon ngushtësisht me Departamentin e Informatikës, që funksionon në kuadër të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Ky bashkëpunim shtrihet në nivelin e hartimit të kurrikulës, zhvillimit të moduleve teknologjike, përfshirjes së stafit akademik nga fusha e informatikës dhe në ndarjen e resurseve laboratorike për realizimin e praktikave mësimore. GVJ vlerëson pozitivisht bashkëpunimin ndërdepartamental për realizimin e komponentëve të informatikës në programin “Informatikë Biznesi”. <i>Megjithatë, në funksion të forcimit të kapaciteteve të brendshme të njësive bazë, rekomandohet që Departamenti i Menaxhimit të parashikojë në strukturën e tij edhe staf akademik me formim në fushën e informatikës së biznesit ose informatikës ekonomike, me qëllim mbulimin e lëndëve që lidhen me teknologjinë e informacionit në kontekstin e biznesit.</i> <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT ‘FAN S. NOLI’.pdf</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është strukturuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë dhe përmbush kërkesat e përcaktuara në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, të ndryshuar. Plani mësimor i këtij programi (Aneksi 2.2) përmban informacion të detajuar për secilin vit dhe semestër të studimit, përfshirë ndarjen e moduleve/lëndëve, ngarkesën mësimore dhe kreditet përkatëse. GVJ konstaton se plani mësimor përfshin: • Struktura e programit në javë për çdo semestër (mësim, praktikë, provime, diplomë);

	• Emërtimi i moduleve të ndara sipas kategorive formuese dhe të grupuara në semestra; • Numri i krediteve ECTS për çdo modul; • Orët e parashikuara për leksione, seminare, ushtrime, laboratorë dhe detyra kursi; • Ngarkesa jashtë auditorit (punë individuale e studentit); • Mënyra dhe afatet e vlerësimit për çdo modul; • Statusin e lëndës (e detyrueshme / me zgjedhje). Plani mësimor përditësohet çdo vit akademik dhe miratohet nga Senati i UNIKO, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të FE, Kreu II, Neni 6 dhe Neni 14 (Aneksi I.28). Propozimet për ndryshime në planin mësimor bëhen në fund të çdo viti akademik nga Departamenti i Menaxhimit në një mbledhje të posaçme, dhe zbatimi i tij mbikëqyret nga drejtuesi i departamentit. Plani mësimor u vihet në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve, përmes stendave informuese të fakultetit, Zyrës së Informimit dhe Orientimit të Studentëve, si dhe përmes publikimit në faqen zyrtare të universitetit (www.uniko.edu.al) në rubrikën “Programe Studimi”. Referenca: <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> Faqe web: https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fe&tipi=ba&programi=infbiz
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga takimet në institucion dhe nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit GJV konstaton se kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve për programin Bachelor në “Informatikë Biznesi” janë të përcaktuara në dokumentet rregullatore të Universitetit “Fan S. Noli” (UNIKO), përkatësisht në: Statutin e UNIKO; Rregulloren e UNIKO; Rregulloren e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë; Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit dhe Rregulloren e Programit të Studimit, Neni 11 dhe Neni 12. Pranimi i studentëve në këtë program studimi bëhet mbi bazën e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë dhe plotësimit të



	kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), si dhe në përputhje me kuotat e miratuara. Për çdo vit akademik, UNIKO publikon kriteret shitesë për pranimin në program, të cilat miratohen nga Senati Akademik dhe shpallen publikisht. Gjithashtu, në rregulloret përkatëse përcaktohen qartë procedurat dhe kriteret për: • Transferimin e studimeve brenda dhe jashtë institucionit; • Ekuivalentimin e krediteve dhe rezultateve të arritura në institucione të tjera; • Njohjen e moduleve të përbashkëta ose të ngjashme të ndjekura në programe të tjera të ngjashme. Të gjitha këto informacione janë të dokumentuara dhe të aksesueshme për studentët në faqen zyrtare të universitetit www.uniko.edu.al, si dhe në zyrat e informacionit dhe orientimit për studentët. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDASHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Faqe Web: https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimit-2/</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga dokumentacioni përkatës i dorëzuar në DVV dhe nga takimet në instucion, në përputhje me kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021, syllabuset për secilën lëndë përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi: titullin e lëndës dhe të titullarit; vitin dhe semestrin kur ofrohet; numrin e krediteve dhe ngarkesën në orë brenda dhe jashtë auditorit; objektivat dhe rezultatet e të nxënës; përmbajtjen tematike javore; metodat e mësimdhënies; format e vlerësimit (provime, detyra kursi, pjesëmarrje në seminare, projekte). Komponentët formues të programit përfshijnë leksione, seminare, ushtrime laboratorike, projekte, praktikë profesionale dhe temën e diplomës, të shpërndara sipas planit mësimor dhe të detajuara në syllabuset përkatëse. Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua se studentët njihen me

	përmbajtjen dhe kërkesat e secilës lëndë në fillim të semestrit nga pedagogët përkatës. Informacionet janë gjithashtu të dokumentuara dhe të aksesueshme përmes Sekretarisë Mësimore dhe në faqen zyrtare të universitetit. GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” përmban informacionet e nevojshme për të gjithë komponentët formues, por formati i programit të lëndës nuk paraqitet siaps formatit të miratuara (Shtojca nr. 2 PROGRAMI I LËNDËS, VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018). <i>Rekomandohet që syllabuset/programet e lëndëve të përditësohen dhe të standardizohen më tej, në përputhje të plotë me kërkesat e Shtojcës Nr. 3 të VKM Nr.41/2018 dhe akteve pasuese.</i> <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga takimet me stafin akademik dhe drejtues në institucion GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është objekt i rishikimit dhe përditësimit periodik, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe në bazë të përcaktimeve të Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë (FE), Kreu XIII, Neni 105 (Aneksi 1.28). Institucioni ka ngritur një praktikë të strukturuar për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, ku përfshihen: • analizat e zhvilluara nga stafi akademik, përmes relacioneve të dorëzuara në fund të çdo viti mësimor; • studimet e tregut të punës (Aneksi 2.17); • rekomandimet e NJSBC-së dhe aktorëve të jashtëm të lidhur me fushën; • si dhe opinionin e studentëve, përmes anketave dhe diskutimeve të hapura në klasë. Gjithashtu, përmirësimet e propozuara analizohen nga Departamenti i Menaxhimit dhe përcillen në Dekanat, i cili i shqyrton dhe i propozon për miratim në Senatin Akademik të UNIKO. Ndryshimet e miratuara reflektohen në planin mësimor, syllabuse dhe dokumentacionin mbështetës përkatës.

	Në këtë program studimi ishte shtuar lënda Inteligjencë Biznesi nga studimi i kryer. Për të garantuar transparencë dhe akses për studentët dhe palët e interesuara, dokumentacioni i miratuar publikohet: në faqen zyrtare të universitetit; përmes platformës Moodle dhe paketës Office 365 for Education, që mbështesin mësimdhënien dhe komunikimin interaktiv dhe përmes stendave informuese në mjediset e fakultetit dhe materialeve promovuese të shpërndara nga Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA). <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.17 STUDIMET E TREGUT.pdf</i> <i>Aneksi 2.12 NDRYSHIME NË PLANIN MËSIMOR TË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi është i strukturuar qartë dhe përmban elementët përbërës të një kurrikule, duke përfshirë ndarjen semestrale të lëndëve, ngarkesën mësimore brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, si dhe komponentët formues (leksione, seminare, laboratorë, ushtrime dhe projekt-kursi). Kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale dhe të aksesueshme nga studentët. GVJ konstaton gjithashtu se institucioni ka ndërtuar një mekanizëm funksional për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Procesi i rishikimit pasqyrohet me korrektësi në dokumentacionin përkatës dhe miratohet sipas hierarkisë institucionale.</i> <i>Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm, GVJ rekomandon:</i> <i>• Përmirësimin dhe standardizimin e formateve të syllabuseve, në përputhje me Shtojcën Nr. 3 të VKM Nr.41/2018, për të siguruar një qasje unike dhe të lehtë për studentët;</i> <i>• Forcimin e kapaciteteve të brendshme të Departamentit të Menaxhimit, duke përfshirë staf akademik me formim në fushën e teknologjisë së informacionit dhe orientim në informatikën e aplikuar në biznes;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe kurrikulave të lëndëve GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është ndërtuar në përputhje me objektivat formues të ciklit të parë të studimeve, si dhe me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, duke ofruar një shpërndarje të balancuar të lëndëve bazë, karakterizuese dhe me zgjedhje në fushat e menaxhimit dhe teknologjisë së informacionit. Plani mësimor (Aneksi 2.2) i programit përmban strukturë të qartë semestrale, ndarje të moduleve sipas kategorive formuese, orë mësimore brenda dhe jashtë auditorit, si dhe komponentë praktikë dhe përfundimtarë (projekti i diplomës). Përmbajtja e moduleve ndërthur njohuritë teorike dhe aftësitë praktike, duke përfshirë leksione, seminare, ushtrime laboratorike dhe projekte, të cilat janë të orientuara drejt formimit të aftësive të nevojshme për tregun e punës, si dhe për ndjekjen e studimeve të mëtejshme në ciklet e larta. Programi përfshin një numër të konsiderueshëm lëndësh në fushën e informatikës dhe menaxhimit, të cilat janë të përzgjedhura në funksion të zhvillimit të kompetencave ndërdisiplinore. Përfshirja e lëndëve si “Bazat e programimit”, “Bazat e të dhënave”, “Rrjetet kompjuterike”, “Inteligjenca e Biznesit”, “Menaxhimi i sistemeve informatike”, “Analiza dhe projektimi i sistemeve”, “Ekonomi”, “Kontabilitet”, dhe “Statistikë”, përbën një bazë solide për përgatitjen profesionale dhe akademike të studentëve. Ky program vlerësohet si i orientuar drejt rezultateve të të nxënit dhe kërkesave të tregut të punës, ndërkohë që përmban të gjitha elementët e nevojshëm për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave përkatëse për nivelin e kualifikimit të ciklit të parë. Referenca: <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>

	<i>Faqe web:</i> https://unkorce.edu.al/sites/default/files/planet_mesimore_2025/(BA180)%20Informatik%C3%AB%20Biznesi%20(plani%20Aktiv-Sekretari,%202024-2025).pdf
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion me stafin akademik GVJ konstaton se kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” (Aneksi 2.1) është konceptuar dhe strukturuar në mënyrë që të përmbushë objektivat formues dhe rezultatet e të nxënit në përputhje me nivelin e kualifikimit të ciklit të parë. Lëndët/modulet pasqyrojnë fushat përkatëse të informatikës dhe të menaxhimit, duke i dhënë studentëve një formim të integruar ndërdisiplinor. Plani mësimor (Aneksi 2.2) përfshin: • Shpërndarjen e lëndëve në vite akademike dhe semestra, në mënyrë progresive; • Përcaktimin e krediteve dhe ngarkesës orare sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar); • Strukturimin e disiplinave në lëndë bazë, karakterizuese, integruese, me zgjedhje dhe komponentë përmbyllës (projekt diplome); • Mbulesën tematike të moduleve, e cila reflekton aktualitetin në fushat e teknologjisë së informacionit në biznes; • Përcaktimin e qartë të orëve të leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe detyrave praktike për çdo modul. Kreditet ECTS janë të përcaktuara për çdo modul në përputhje me ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë tij, duke përfshirë punën e pavarur të studentit, dhe janë të kalibruara sipas përqindjes për secilën kategori disiplinore. Programi ka ruajtur balancën midis formimit teorik dhe praktik, duke përfshirë komponentë të rëndësishëm si: “Bazat e të dhënave”, “Rrjetet kompjuterike”, “Analiza e sistemeve”, “Programimi”, “Statistika”, “Ekonomi”, dhe “E-biznesi”. Këto module janë të harmonizuara me praktikat ndërkombëtare dhe mbështesin aftësimin profesional dhe përgatitjen për tregun e punës. Gjithashtu, GVJ vëren se një pjesë e stafit akademik që mbulon lëndët e programit ka përfituar eksperiencë ndërkombëtare përmes projekteve Erasmus+ dhe bashkëpunimeve akademike, gjë që ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulës dhe përafrimin e saj me programet homologe të BE-së.

Referenca:

Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf

Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf

Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf

Takimet në institucion

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Struktura e programit Bachelor në “Informatikë Biznesi” respekton në mënyrë rigoroze kërkesat e përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar) dhe është në përputhje me udhëzimet e Shtojcës 1, Tabela 1 për shpërndarjen e krediteve sipas kategorive të komponentëve mësimorë. Sipas planit mësimor dhe kurrikulës zyrtare (Aneksi 2.2), totali i krediteve të programit është 180, të strukturuar si më poshtë:

Kategori a	Lloji i lëndëve	Kredite	%	Kërkesa ligjore
A	Lëndë bazë	33	18.3%	15% – 20%
B	Lëndë karakterizuese	97	53.9%	50% – 55%
C	Lëndë ndërdisiplinore/integru uese (me zgjedhje)	25	13.9%	12% – 15%
D	Lëndë plotësuese (praktika)	10	10.0%	10% – 15%
E	Detyrime përmbyllëse (mikroteza)	3.9	2.2%	3% – 5%
	Totali	180	100%	

Nga kjo shpërndarje janë gjithsej 1963 orë në auditor, me këtë shpërndarje:

- Leksionet (1092 orë) përbëjnë rreth 55.6% të totalit;
- Seminaret/laboratorët (871 orë) përbëjnë rreth 44.4%;

Nga takimi me stafin akademik në institucion seminaret zhvillohen edhe në laboratorë për lëndët e profilit. Kjo shpërndarje tregon se programi ka një balancë të qëndrueshme ndërmjet përgatitjes teorike, përmbajtjes praktike dhe fleksibilitetit në përzgjedhjen e moduleve, si dhe përmbush të gjitha standardet për formimin e studentëve në këtë profil. Përqindjet janë brenda kufijve të parashikuar ligjërisht, gjë që

	dëshmon për një hartim të kujdesshëm të kurrikulës dhe orientim të qartë drejt rezultateve të të nxënës dhe nevojave të tregut të punës. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Tabelat përmbledhëse, Plani mësimor për vitin akademik 2024-2027</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit “Informatikë Biznesi” është ndërtuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, dhe përmban një shpërndarje të mirëbalancuar të komponentëve teorikë dhe praktikë, që mbështet realizimin e objektivave formues, punësimin, si dhe mundësinë për transferim apo mobilitet akademik. Kategoria e lëndëve ndërdisiplinore/integruese përmban 7 module, të cilat përfaqësojnë 13.8% të krediteve, në përputhje me kërkesat ligjore (12–15%). Modulet si Komunikimi në biznes, Matematika e zbatuar në biznes, Inteligjenca e biznesit, Menaxhim risku dhe Marketingu në internet, përfshihen si lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje që synojnë zhvillimin e kompetencave të aplikuara dhe të ndërlidhura me sektorët aktualë të tregut të punës. Lëndët plotësuese përfshijnë 4 module me një total prej 10% të krediteve, përfshirë Gjuhë e huaj, Programim në Web, Ligje për informaticienët e biznesit dhe Praktikën profesionale. Kjo e fundit zhvillohet në fund të vitit të tretë, në bashkëpunim me subjekte partnere publike dhe private, duke ofruar përvojë të drejtpërdrejtë në ambiente reale pune dhe ndihmuar integrimin profesional të studentëve. Detyrimi përmbyllës (teza e diplomës) përbën 3.8% të krediteve dhe organizohet në formën e një mikroteze, e cila përgatitet në përputhje me Udhëzuesin për Diplomimin (Aneksi II.07), duke demonstruar aftësitë kërkimore dhe zbatimin praktik të njohurive të fituara gjatë programit. Struktura e përgjithshme e programit përfshin një total prej 4,500 orësh, të ndara në veprimtari formuese si leksione, seminare, ushtrime, punë laboratorike, detyra kursi, praktikë dhe përgatitje e mikrotezës,

	këto përbëjnë 1963 (43.6%) orë dhe ngarkesa në orë jashtë auditorit është 2537(56.4%) orë për punë individuale. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTIT I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga takimet me stafin akademik dhe analizimi i përmbajtjes së dosjeve në DVV, GVJ konfirmon se syllabuset janë të strukturuar mirë dhe në përgjithësi përmbajnë informacionet e nevojshme për të siguruar arritjen e rezultateve të të nxëniet në përputhje me profilin e programit dhe nevojat e tregut të punës. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përmbajtjes së moduleve në programin Bachelor në “Informatikë Biznesi” realizohet përmes përditësimit të vazhdueshëm të syllabuseve, veçanërisht në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e tregut të punës. Nga RVB dhe shqyrtimi i dokumentacionit (Aneksi 2.16/2022–2023, Aneksi 2.16/2023–2024, dhe Aneksi 2.16/2024–2025), rezulton se rreth 61% e moduleve zhvillohen me tekste universitare të aksesueshme në bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë, çka garanton mbështetje reale për procesin mësimor. Në secilin syllabus, në seksionin përkatës të literaturës, jepen referenca të qarta dhe të plota për librat bazë dhe ndihmës, duke përfshirë botime të viteve të fundit. Për më tepër, biblioteka digjitale e universitetit (U-LIBRARY) i ofron stafit dhe studentëve akses në EBSCO Publishing Databases, ku ata mund të regjistrohen dhe të përdorin një gamë të gjerë artikujsh shkencorë dhe burimesh didaktike. Gjithashtu, anëtarësimi i FE në Education Membership Scheme (EMS) i ka mundësuar përdorimin e IoH eLibrary të Institute of Hospitality, duke shtuar burime cilësore për literaturën dhe kërkimin shkencor. Në përputhje me rregulloret institucionale dhe nenet përkatëse të Rregullores së Fakultetit dhe Departamentit të Menaxhimit, syllabuset përmbajnë të gjitha komponentët përkatës si: titulli i modulit, titullari dhe kreditet, viti dhe semestri kur zhvillohet, kategoria e lëndës, temat javore,



	metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe literatura bazë dhe ndihmëse. <i>Referencat:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDASHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf (Aneksi 2.16/2022–2023, Aneksi 2.16/2023–2024, dhe Aneksi 2.16/2024–2025)</i> <i>RVB BA IB.pdf</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Në vlerësimin GVJ-së, përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” garanton në mënyrë të plotë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që janë përcaktuar si objektiva formuese të programit. Struktura dhe përmbajtja e programit janë të hartuara në mënyrë që të sigurojnë tek studentët një formim të qëndrueshëm teorik dhe praktik, të nevojshëm për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Programi synon të përgatisë specialistë me kompetenca profesionale të avancuara në fushën e informatikës së biznesit, të aftë për punësim në sektorë të ndryshëm si: • administrimi i sistemeve të bazave të të dhënave; • zhvillimi i aplikacioneve të biznesit; • analiza e të dhënave dhe Inteligjenca e Biznesit; • menaxhimi i projekteve teknologjike; • shërbimet digjitale në biznes, dhe fusha të tjera të ngjashme; Studentët fitojnë njohuritë dhe aftësitë praktike të nevojshme për të kontribuar efektivisht në organizata publike dhe private, duke përfshirë edhe sektorin e teknologjisë së informacionit në biznes. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>

	<i>Faqe web:</i> https://unkorce.edu.al/sites/default/files/planet_mesimore_2025/(BA180)%20Informatik%C3%AB%20Biznesi%20(plani%20Aktiv-Sekretari,%202024-2025).pdf
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga takimet në instiutcion me stafin akademik dhe me studentët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit sistemi i njohurive dhe kompetencave që ofrohen nga programi Bachelor në “Informatikë Biznesi” i mundësojnë studentëve të vazhdojnë me sukses studimet e tyre në ciklin e dytë (Master), si brenda fushës së informatikes së biznesit, ashtu edhe në programe të tjera të specializuara që lidhen ngushtë me këtë profil, si p.sh. Master Profesional në Administrim Biznesi, Marketing Digjital ose Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit në Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane te ketij universiteti. Departamenti përkatës bashkëpunon me profesionistë dhe përfaqësues të industrisë për të përshtatur dhe përmirësuar vazhdimisht programin në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo siguron që studentët të pajisen me aftësi të nevojshme për punësim në sektorin privat dhe publik. Nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni-t (QKA), universiteti mbledh dhe përditëson të dhëna mbi punësimin e diplomantëve, duke ndihmuar në orientimin profesional dhe lidhjen me tregun e punës. Studentët e programit kanë mundësi të zgjedhin dhe specializohen në drejtimet që i përshtaten interesave dhe objektivave të tyre profesionale. Përvoja praktike e stafit akademik, përfshirë pedagogët me angazhim të pjesshëm në sektorin profesional, ndihmon në lidhjen e mësimi teorik me nevojat reale të tregut, duke siguruar përgatitjen e duhur të studentëve për karrierë të suksesshme. <i>Refernca:</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i> <i>Takimet në strukturat drejtuese dhe studentët</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se strukturimi i kurrikulës, përmbajtja e lëndëve, ndarja e moduleve në vite e semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, është i përshtatur mirë për të arritur

	objektivat e programit dhe për të siguruar zhvillimin e kompetencave të nevojshme për studime të mëtejshme apo punësim të suksesshëm në fushën e informatikës së biznesit. Programi siguron një formim të balancuar dhe të përshtatshëm për zhvillimin profesional të studentëve, duke i pajisur ata me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e kërkuara për një karrierë të suksesshme në fushën e informatikës së biznesit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Referuar RVB, si dhe gjatë vizitës në institucion me stafin akademik u theksua se përditësimi i përmbajtjes së programit, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së tij, është një aktivitet periodik dhe i integruar në proceset e zhvillimit të programit. Në takimin me dekanen, përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik u konfirmua se rishikimi dhe përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit realizohet duke marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Referuar dokumentacionit shoqërues, përfshirë listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit, GVJ konstatoi se UNIKO dhe Fakulteti i Ekonomisë (FE) disponojnë një rrjet të konsoliduar bashkëpunimi me institucione publike, sipërmarrje dhe biznese private, institucione financiare, banka dhe kompani sigurimi. Këto marrëveshje synojnë shkëmbimin e eksperiencës dhe ekspertizës në funksion të përmirësimit dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit. Strukturat përkatëse dhe njësitë përgjegjëse për zhvillimin e programeve marrin parasysh propozimet dhe nevojat e institucioneve partnere dhe aktorëve të tjerë të tregut të punës, duke kontribuar në përshtatjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes dhe strukturës së programit të studimit, në përputhje me kërkesat e tregut dhe zhvillimet aktuale profesionale kjo gjë

	pasqyrohet dhe në ndryshimet peridike në planin mësimor duke ju përmbajtur kritereve të ligjit të arsimit të lartë. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.17 STUDIMET E TREGUT.pdf</i> <i>Aneksi 2.12 NDRYSHIME NË PLANIN MËSIMOR TË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>RVB BA IB.pdf</i> <i>Takimet në institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga takimet me studentët dhe strukturat drejtuese në Departamentin e Menaxhimit të UNIKO-së, u konstatua se studentët kanë përfaqësues në të gjitha strukturat drejtuese dhe shprehen se ndihen të dëgjuar dhe të vlerësuar për kërkesat e tyre. Gjithashtu, në këto takime morën pjesë përfaqësues nga Alumni-t, ku kontakti me ta ka qenë i hershëm dhe i vazhdueshëm, duke mundësuar bashkëpunim aktiv në organizimin e aktiviteteve të ndryshme dhe në përmirësimin e programeve të studimit. Referuar RVB si dhe gjatë vizitës në Institucion, përfaqësues të departamentit u shprehën se përditësimi i përmbajtjes së programit mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës ishte një aktivitet periodik dhe në përputhje me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, Statutin e UNIKO-së (Kreu VIII, Neni 79, Pika 2), studentëve u jepet e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur si përfaqësues në organet vendimmarrëse të universitetit, përfshirë Senatin Akademik dhe komisionet përkatëse. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore, institucioni dhe nivel kombëtar (Statuti i UNIKO-së, Kreu VIII, Neni 80 dhe Rregullorja e Brendshme e FE). UNIKO garanton përfshirjen aktive të studentëve në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur që marrin pjesë në: • Senatin Akademik të UNIKO-së, ku përfaqësimi i studentëve është 10% i anëtarëve të Senatit;

- Këshillin e Etikës të UNIKO-së;
- Njësinë e Strukturës së Bashkëpunimit dhe Konsultimit (NJSBC) në nivel institucioni dhe fakulteti;
- Komisionin Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe Komisionin e Zgjedhjeve në Fakultet (KZF);

Procesi i zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve është transparent dhe garanton barazinë në pjesëmarrje, duke mundësuar që ata të ndikojnë drejtpërdrejt në vendimmarrjet që lidhen me aspektet akademike dhe organizative të universitetit. Studentët organizohen në Këshilla Studentore në nivel njësie kryesore dhe institucioni, ku veprimtaria e tyre rregullohet sipas Rregullores së Këshillit Studentor. Në Fakultetin e Ekonomisë, çdo grup mësimor zgjedh dy senatorë si përfaqësues në Këshillin Studentor të fakultetit, i cili promovon dhe koordinon pjesëmarrjen e studentëve në organet drejtuese të universitetit, në strukturat mësimore, kërkimore dhe shërbimet mbështetëse. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për çështje të ndryshme me interes për universitetin, duke përfshirë planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtarinë mësimore, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive kulturore, artistike dhe sportive. Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) bashkëpunon ngushtë me studentët dhe alumnit për të mbledhur opinione dhe sugjerime që ndikojnë në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, duke u bazuar në kërkesat reale të tregut të punës. Kjo qendër organizon pyetësorë dhe takime me studentët e diplomuar dhe punëdhënësit, duke mbledhur të dhëna të dobishme për zhvillimin profesional dhe adaptimin e programeve në përputhje me nevojat e tregut.

Referenca:

Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf

Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf

Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf

Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf

Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf

Aneksi 1.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për autoritet dhe organet drejtuese UNIKO - Kreu II



Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse e programit të studimit Departamenti i Menaxhimit dhe strukturat akademike të Fakultetit të Ekonomisë, gjatë takimeve në institucion u shprehën se përmirësimi dhe përshtatja e përmbajtjes së programit të studimit bëhet në mënyrë periodike, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse si dhe në konsultim të vazhdueshëm me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës. Gjithashtu, referuar dokumentacionit përkatës, FE dhe në veçanti Departamenti i Menaxhimit, ka realizuar bashkëpunime konkrete me institucione publike dhe private, ndërmarrje, banka, kompani sigurimi dhe aktorë të tjerë, të cilët kontribuojnë me ekspertizën e tyre për rishikimin dhe përshtatjen e moduleve të programit të studimit. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit (Aneksi 1.34), përfshihen praktikant më të mira të tregut dhe kërkesat aktuale për profilet profesionale të kërkuara. Pedagogë me kohë të pjesshme, të cilët janë të punësuar në institucione dhe biznese të rëndësishme financiare apo teknologjike, kontribuojnë në afrim të përmbajtjes akademike me realitetin e tregut të punës. Nga takimet në institucion dhe RVB aktualisht, Departamenti i Menaxhimit po zbaton një projekt kërkimor të financuar nga të ardhurat e Universitetit, i cili ka si qëllim të vlerësojë ndikimin e praktikës në zhvillimin e aftësive dhe qëllimeve profesionale të studentëve. Rezultatet e këtij projekti, që pritet të finalizohet në janar 2025, do të përdoren si bazë për përmirësimin e syllabuseve dhe komponentëve të praktikës në programin e studimit, duke forcuar lidhjen midis arsimit dhe tregut të punës. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.17 STUDIMET E TREGUT.pdf</i> <i>Aneksi 2.12 NDRYSHIME NË PLANIN MËSIMOR TË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>RVB BA IB.pdf</i> <i>Takimet në institucion</i> <i>Faqe web: https://unkorce.edu.al/projekte/</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe takimeve me aktorët institucionalë, GVJ vlerëson se institucioni përmbush plotësisht kriterin për nxitjen dhe përfshirjen aktive të studentëve dhe strukturave të tyre në procesin e përmirësimit</i>



	të vazhdueshëm të programeve të studimit, duke mbajtur kontakte dhe konsultime të rregullta me studentët e diplomuar dhe aktorët e tjerë relevantë. GVJ vlerëson se ekzistojnë mekanizma të qartë dhe funksionalë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, në bashkëpunim me rrjete të profesionistëve dhe aktorë të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, takimet në institucion me stafin akademik dhe me studentët në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, format dhe metodat e mësimdhënies/mësimnxënies janë të strukturuar në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.03.2021, si dhe me aktet rregullatore të brendshme të universitetit dhe të Fakultetit të Ekonomisë. Referuar Rregullores së Fakultetit të ekonomisë (Kreu IX) dhe planit mësimor dhe programeve të lëndëve për këtë program (Aneksi 2.2), GVJ konstaton se format e aplikueshme të mësimdhënies përfshijnë: leksionet, seminarët, ushtrimet praktike, prezantimet, diskutimet, analizën e rasteve, esetë, projektet/detyrat e kursit, praktikat profesionale, orët e hapura, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, si dhe temën e diplomës.

Qëllimi në përzgjedhjen e këtyre metodave është orientimi i procesit mësimor drejt parimit të të nxënës me studentin në qendër, duke integruar metoda aktive dhe aplikimi i tyre praktik në laboratore. Nga vizita në auditore, takimi me stafin dhe studentët përdorimi i teknologjive të avancuara, si pajisje audio-vizive, kompjuterë, platforma digjitale mësimore, ndihmon në zhvillimin e një mjedisi bashkëkohor mësimor, të favorshëm për të nxënësit interaktiv dhe bashkëpunues. Gjithashtu, referuar programeve të lëndëve, GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet bazë dhe të detajuara si: titulli i lëndës, titullari, kreditet, lloji dhe kategoria e lëndës, viti dhe semestri i zhvillimit, temat, literatura bazë dhe ndihmëse, si dhe mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të njohurive të studentit. Procedurat e vlerësimit të studentëve janë të detajuara në rregulloret përkatëse (Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu X, Rregullorja e Programit të Studimit Informatikë Biznesi), dhe përfshijnë komponentë të tillë si:

- provimi i ndërmjetëm;
- aktivizimi në seminare;
- projekte/detyra kursit;
- provimi përfundimtar;

Vlerësimi i vazhduar është në masën 30 % dhe vlerësimi në provim përfaqëson 70% të vlerësimit përfundimtar. Format e kontrollit të njohurive për vlerësimin e vazhduar kanë këtë shpërndarje (Tabela 15):

- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 5-10%
- Plotësimi i detyrimeve (laboratore dhe detyra kursit) 10-20%
- Testimet gjatë vitit 10-20%

Kjo ndarje është kompetencë e pedagogëve të lëndës. Sipas nenit 7 të rregullores së programit, studenti ka detyrimin të ndjekë seminarin dhe ushtrimet në masën minimale prej 75% të totalit të orëve për secilën lëndë. Infrastruktura institucionale që mbështet këtë program është e përshtatshme dhe e pajisur me mjetet e nevojshme për zhvillimin efektiv të procesit mësimor.

Referenca:

Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf

Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf

Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf

	<i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Takimet dhe vizitat në institucion</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga takimet me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, mësimdhënia trajtohet si një proces ndërveprues midis stafit akademik dhe studentëve, me synimin për të respektuar larminë në nivelet, nevojat dhe motivimet individuale të studentëve. Për këtë arsye, personeli akademik përdor një gamë të gjerë metodash alternative, përveç metodave klasike si: • leksionet, seminarët dhe ushtrimet; • rastet studimore, diskutimet interaktive, esetë; projektet/detyrat e kursit; • praktika profesionale dhe punimi i diplomës; Në vitet e dyta dhe të treta të programit, theksi vendoset gjithnjë e më shumë mbi metodat praktike dhe laboratorike, për të përgatitur studentët në zbatimin konkret të njohurive në fusha reale të biznesit dhe teknologjisë së informacionit. Kjo i ndihmon ata të zhvillojnë aftësi kritike dhe profesionale, në përputhje me nevojat e tregut të punës. Gjatë takimeve të GJV me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se mësimdhënia zhvillohet në mënyrë interaktive, përmes: • aktivizimit të studentëve gjatë leksioneve dhe seminareve; • punës në grup dhe individuale; • angazhimit në projekte konkrete të integruara në kurrikulë; Personeli akademik, në përgjigje të larmisë së studentëve dhe për t'i përfshirë ata sa më shumë në procesin e të nxënës, adaptuan qasje të personalizuar, veçanërisht në modulën e praktikës profesionale dhe përmes aktiviteteve jashtë auditorit. Referuar Rregullores së Programit të Studimit, si dhe syllabuseve të lëndëve format e mësimdhënies janë të larmishme dhe të përshtatura për të nxënësit efektiv dhe aktiv të studentëve. Këto forma synojnë jo vetëm transmetimin e njohurive, por edhe zhvillimin e kompetencave të nevojshme për përfshirjen në tregun e punës, në mënyrë të pavarur dhe të aftë për të marrë vendime.



	<i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga vizitat në institucion me stafin akademik dhe referuar dokumentit të RVB, UNIKO dhe dy fakultet të cilat bashkëpunojnë për ofrimin e këtij program studimi Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane i kushtojnë një rëndësi të veçantë përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive pedagogjike dhe didaktike të stafit akademik. Kompetencat didaktike konsiderohen të përbëjnë një nga shtyllat kryesore të cilësisë në mësimdhënie dhe përfshijnë elementë të tillë si: • Përzgjedhja e metodave të përshtatshme të mësimdhënies; • Hartimi metodik i leksioneve; • Planifikimi efikas i kohës mësimore; • Performanca didaktike; • Organizimi fizik dhe hapësinor i ambienteve mësimore; Për të mbështetur këto aspekte, institucioni ndërmerr masa konkrete dhe të vazhdueshme për trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik, duke përfshirë: • Promovimin e praktikave më të mira të mësimdhënies dhe mësimnxënies; • Organizimin e leksioneve të hapura dhe debatit akademik për shkëmbimin e përvojave; • Trajnimin nga pedagogë të kualifikuar dhe ekspertë vendorë e ndërkombëtarë; • Shkëmbimin e eksperiencave me institucione homologe përmes marrëveshjeve ndërkombëtare dhe programeve të mobilitetit Erasmus+; Gjithashtu, gjatë vizitave u konfirmua angazhimi i stafit në projekte inovative, si ato që lidhen me Inteligjencën Artificiale, si dhe mbështetja aktive e studentëve për zhvillimin e tyre profesional përmes informimit mbi mundësitë e internshipeve,

	pjesëmarrjes në konferenca, programeve Erasmus+ dhe aktiviteteve të tjera akademike. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 4.4 PROJEKTE DHE MOBILITETE.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> https://unkorce.edu.al/category/kerkimishkencor/projekte/projekte-te-financuara-nga-uniko/ https://unkorce.edu.al/nderkombetare/ https://unkorce.edu.al/projekte-kombetare/ https://unkorce.edu.al/mobilitete/
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në programin bachelor në “Informatikë Biznesi”, i cili ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit në bashkëpunim me Departamentin e Informatikës, është kompetent dhe i përgatitur për të shpjeguar njohuritë dhe konceptet përkatëse në përputhje me objektivat e të nxënit. Ky bashkëpunim ndërdisiplinor siguron që përmbajtja dhe metodat mësimore të jenë të përshtatura me natyrën e fushës së studimit dhe kërkesat e tregut. Staf i akademik përbëhet nga pedagogë me kualifikime të avancuara akademike dhe përvojë profesionale relevante, të cilët përdorin metoda të ndryshme mësimdhënieje interaktive dhe praktike, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe zhvillimin e mendimit kritik, krijues dhe autonom. Në procesin mësimor kombinohen forma klasike dhe moderne të mësimdhënies, duke përfshirë leksionet, seminarët, ushtrimet, rastet studimore, projektet dhe praktikatat profesionale, që i përgjigjen heterogjenitetit dhe nevojave të ndryshme të studentëve. Bashkëpunimi i ngushtë mes dy departamenteve siguron integrimin e njohurive të menaxhimit dhe teknologjisë së informacionit, duke forcuar aftësitë e studentëve për të përballuar sfidat e tregut të punës në mënyrë efektive. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.19 CV - STAFI AKADEMIK - PROGRAMI I STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>

	<i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Takimet në institucion me stafin akademik</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe zyrën e NjSBC në institucion programi i studimit “Informatikë Biznesi”, i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit në bashkëpunim me Departamentin e Informatikës, vlerëson dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët në këtë proces përmes instrumenteve të ndryshëm të vlerësimit. Cilësia e mësimdhënies është objekt i vlerësimit periodik dhe mbështetet në analizën e relacioneve të pedagogëve, vlerësimeve të studentëve nëpërmjet pyetësorëve të organizuar në fund të çdo semestri nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Studentët kontribuojnë aktivisht përmes feedback-ut të tyre në vlerësimin e përmbajtjes së lëndëve, metodave të përdorura dhe performancës së stafit akademik. Këto të dhëna analizohen dhe shërbejnë si bazë për përmirësimet e nevojshme në procesin mësimor. Institucioni i kushton rëndësi të veçantë transparencës, përfshirjes dhe reflektimit të opinionëve të studentëve për të siguruar një proces mësimdhënieje që përmbush objektivat e të nxënësve dhe i përgjigjet kërkesave bashkëkohore të arsimit të lartë. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 3.1 MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE.pdf</i> <i>Takimet në institucion me NjSBC, studentët dhe stafin akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat	Nga takimet në institucion, dokumentacioni i dorëzuar dhe dokumenti i RVB institucioni i arsimit të lartë UNIKO ka ngritur dhe funksionalizuar struktura të mirëorganizuar në nivel institucional dhe fakultetesh për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në nivel institucional, përgjegjës për sigurimin e standardeve të cilësisë është Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA), ndërsa në nivel fakulteti funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), në bashkëpunim me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, Koordinatorët e programeve, Qendrat e Karrierës dhe Alumni.

dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Këto struktura mbështesin eksperimentimin me metoda inovative të mësimdhënies dhe ofrojnë trajnime të vazhdueshme për stafin akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike. Gjatë vizitës së GVJ, u konfirmua se këto njësi janë të angazhuara aktivisht në vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, të performancës së stafit akademik dhe të rezultateve të punës kërkimore, si dhe në organizimin e aktiviteteve të bashkëpunimit me aktorë të jashtëm si studentët, partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësues të biznesit. Raportet periodike të hartuar nga NjSBC dhe diskutimet ndër-institucionale shërbejnë si bazë për përmirësim të vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe për implementimin e praktikave më të mira evropiane në arsimin e lartë. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 6.1 NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË FAKULTETI EKONOMIK.pdf</i> <i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Takimet në institucion me drejtuesen e departamentit, stafin dhe zyrën e NjSBC</i>			
Konkluzione	GVJ nga analiza e detajuar e dokumentacionit dhe takimet në institucion konstaton se programi i studimit "Informatikë Biznesi", i ofruar nga UNIKO në bashkëpunim ndërdepartamental, garanton një proces mësimor bashkëkohor, të orientuar drejt studentit dhe të mbështetur në metoda të ndryshme interaktive, praktika profesionale dhe teknologji digjitale. Institucioni dhe strukturat përgjegjëse janë të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit, duke përfshirë aktivisht si stafin akademik ashtu edhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	UNIKO ka ndërtuar një sistem të qartë dhe të rregulluar për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve në programin “Informatikë Biznesi”. Kriteret dhe procedurat janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse institucionale, të fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, dhe bëhen publike për studentët përmes syllabuseve dhe dokumentacionit mbështetës. Vlerësimi i studentëve bazohet në një kombinim të vlerësimit të vazhduar (30%) dhe atij përfundimtar (70%). Për vlerësimin e vazhduar, janë parashikuar format e kontrollit si: ndjekja dhe pjesëmarrja aktive në lëndë (5–10%), plotësimi i detyrimeve (laboratorë dhe detyra kursi – 10–20%), si dhe testimet gjatë vitit (10–20%). Kjo ndarje specifike është në kompetencë të pedagogëve të lëndës, duke siguruar fleksibilitet dhe përshtatje me natyrën e modulit. Sipas rregullores së programit, studenti ka detyrimin të ndjekë minimumi 75% të orëve për secilën lëndë, duke garantuar angazhim aktiv në procesin mësimor. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se syllabuset e çdo lënde përmbajnë të gjitha informacionet thelbësore për studentët, përfshirë objektivat, temat, metodat e vlerësimit dhe ndarjen e pikëve. Në fillim të çdo semestri, titullari i lëndës/modulit prezanton përmbajtjen dhe mënyrën e vlerësimit gjatë orës së parë, duke sqaruar qartë strukturën e lëndës, numrin dhe format e testeve, peshën e çdo komponenti, detyrimet e projektit apo detyrës së kursit, si dhe afatet përkatëse. Kjo metodologji

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	vlerësimi publikohet gjithashtu përmes sistemit elektronik “Pitagora”, ku çdo student ka akses individual për të ndjekur progresin e tij dhe kriteret e vlerësimit. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konfirmon se format dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve, përcaktohen në Rregulloren e njësisë bazë dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor Informatikë Biznesi dhe planet mësimore të lëndëve. Këto forma dhe kriteret vlerësimi, përfshijnë: vlerësimin e vazhduar (30%), që përfshinë: provimin e ndërmjetëm, pjesëmarrja dhe aktivizimin në seminare, laboratore/detyra kursi, si dhe provimin përfundimtar (70%). Nota përfundimtare e studentit është totali i elementëve të mësipërm. GVJ gjykon se përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin dhe demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor që zhvillohet lënda/moduli përkatës. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët</i> https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/INFORMIM-I-PERGJITHSHEM-PER-VITET-E-PARA.pdf
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson	Nga takimet me përgjegjësen e departamentit, zyrën e NjSBC dhe studentët departamenti i Menaxhimit, si njësia bazë përgjegjëse për programin "Informatikë Biznesi", demonstroi



format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	një angazhim të vazhdueshëm në vlerësimin dhe përmirësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies. Kjo realizohet nëpërmjet analizave vjetore të punës mësimore, raportimeve të NjsBC, përfshirjes së feedback-ut të studentëve dhe diskutimeve të hapura me stafin akademik. Ndryshimet e propozuara mbështeten në standardet bashkëkohore të arsimit, kërkesat e tregut dhe nevojat e vetë studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.12 NDRYSHIME NË PLANIN MËSIMOR TË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 3.1 MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE.pdf</i> <i>Takimet në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	UNIKO demonstroi angazhim të vazhdueshëm për promovimin e metodave të shumta dhe fleksibile pedagogjike, duke i përshtatur ato me objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës. Nëpërmjet trajnimeve të organizuara nga Sektori i Kurrikulave, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA) dhe përdorimit të platformave moderne të mësimdhënies si Moodle, eduMEET, Google Classroom dhe Office 365, stafi akademik ka përmirësuar aftësitë didaktike dhe ka përforcuar procesin e të nxënit interaktiv. Nga takimet me stafin akademik në institucion u konfirmuar ofrimi i këtyre trajnimeve. <i>Referenca:</i> <i>https://unkorce.edu.al/drejtoria-kurrikulave/</i> <i>https://unkorce.edu.al/staff-mobility/</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit në FE ka rregullore dhe procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin e studentëve, të cilat njihen nga studentët përmes syllabuseve në leksionet e para me studentët dhe me anë të sistemit "Pitagora". Procesi i vlerësimit është i larmishëm, duke kombinuar vlerësimin e vazhduar dhe provimin përfundimtar, si dhe përfshin forma të ndryshme si provime të ndërmjetme, projekte, prezantime dhe punime praktike.</i>

	<i>Institucioni vlerëson dhe përmirëson periodikisht metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe duke përdorur platforma moderne dhe trajnime të vazhdueshme për stafin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentit mbështetet në elementët e kontrollit të vazhdueshëm (provimi i ndërmjetëm, pjesëmarrja, aktivizimi dhe diskutimi në seminare, punë individuale dhe në grup, detyra/projekte kursi, etj.) dhe provimin përfundimtar. Nota përfundimtare e studentit përbëhet nga kombinimi i këtyre elementëve. Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues (syllabyset e lëndëve), si dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se studentët informohen nga pedagogu i lëndës/modulit përkatës për përmbajtjen e lëndës dhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive dhe kontrollit të dijeve. GVJ gjykon se këto forma dhe mënyra vlerësimi i motivojnë studentët të përgatiten gjatë gjithë semestrit në të cilin zhvillohet programi i lëndës/modulit përkatës. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit “Informatikë Biznesi”, konstatoi se institucioni ka

vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	vendosur në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit që rrisin transparencën dhe minimizojnë mundësitë për abuzim. Konkretisht, është implementuar sistemi “CleanScore” për korrigjimin elektronik të testeve dhe provimeve në disa lëndë të programit (si “Bazat e Marketingut”, “Ligje për informaticienët e biznesit”), në kuadër të marrëveshjes me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Gjithashtu, përdorimi i platformave të integruara si Moodle, Google Classroom, Office 365 for Education dhe sistemi institucional “Pitagora” mundëson vlerësim të strukturuar dhe të dokumentuar, të aksesueshëm për pedagogët dhe studentët. Referenca: <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Shtojca 1.6 MARRËVESHJA ME RASH PËR SISTEMIN ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i> <i>Shtojca 1.6.1 MANUAL I SISTEMIT ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga dokumentacionet e dorëzuara dhe takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se vlerësimi përfundimtar i lëndës në programin e studimit “Informatikë Biznesi” realizohet në përputhje të plotë me syllabusin e secilës lëndë dhe me kuadrin ligjor në fuqi. Sipas Rregullores së Brendshme të FE dhe Rregullores së UNIKO-s, testimi dhe vlerësimi përfundimtar realizohet nga komisione provimi të emëruara nga përgjegjësi i departamentit, me jo më pak se dy anëtarë, ku njëri është detyrimisht titullari i lëndës/modulit. Vlerësimi me notë bëhet mbështetur në totalin e pikëve të vlerësimit gjatë vitit/vazhduar, këto në total janë 30 nga vlerësimi përfundimtar dhe pikët e provimit përfundimtar të cilat janë 70 pikë nga vlerësimi përfundimtar. Në të gjitha format e provimit përdoret, sistemi i vlerësimit me 100 pikë, të cilat konvertohen në notë. Konvertimi i pikëve në nota është i pasqyruar në rregulloren e programit, në Kurrikulat e programit të studimit dhe një informacion sqarues studentët mund ta aksesojnë që në fillim të studimeve në faqen web të universitetit. Mënyra e vlerësimit ju komunikohet studentëve në fillim të studimeve gjithashtu edhe në fillim të çdo moduli nga profesori i lëndës. Referenca:

	<i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Takimet me studentët dhe stafin</i> <i>https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/INFORMIM-I-PERGJITHSHEM-PER-VITET-E-PARA.pdf</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ konstatoi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin “Informatikë Biznesi” shoqërohet me mundësi për komente dhe feedback, në përputhje me Rregulloren e UNIKO-s, rregulloret e njësisë bazë dhe të programit të studimit. Nga takimi me studentët dhe stafin u konfirmua se pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të paraqitet pranë komisionit të provimit për të diskutuar mbi rezultatet dhe për të analizuar përgjigjet e tij. Gjatë kësaj procedure, studentit i jepet mundësia të shqyrtojë tezën e provimit, duke i sqaruar pyetjet e gabuara dhe duke u njohur me përgjigjet e sakta. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Takimet me studentët dhe stafin</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga takimi me përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik GVJ konstatoi se në programin Bachelor në “Informatikë Biznesi” janë parashikuar dhe zbatohen rregulla të qarta dhe masa konkrete për shmangien e plagjiaturës dhe kopjimit në provime, të përcaktuara në Rregulloren e UNIKO-s, Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë dhe Kodin e Etikës së institucionit. Gjatë zhvillimit të provimeve, komisionet mbikëqyrin ecurinë e testeve me qëllim garantimin e ndershmërisë akademike. Studentët që përdorin mjete të palejuara përjashtohen nga provimi, në përputhje me dispozitat e përcaktuara.

	<i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Shtojca 1.17 RREGULLORJA E KËSHILLIT STUDENTOR.pdf</i> <i>Shtojca 1.19 Kodi i etikës së UNIKO.pdf</i> <i>Takimet me studentët dhe stafin</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga takimin me stafin akademik GVJ konstatoi se në programin “Informatikë Biznesi” zbatohen procedura të qarta dhe afate të përcaktuara për komunikimin e rezultateve të provimeve, të bazuara në rregulloret institucionale dhe të njësisë bazë. Rezultatet e provimit me gojë komunikohen menjëherë në përfundim të provimit, ndërsa për provimet me shkrim, publikimi bëhet brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij. Pedagogët dorëzojnë procesverbalet me nënshkrimet përkatëse pranë sekretarisë mësimore dhe Sektorit të TIK-ut, ndërsa studentët informohen për rezultatet në mënyrë individuale përmes sistemit elektronik Pitagora. Kjo praktikë u verifikua dhe u konfirmua gjatë vizitës së GVJ në sekretarinë mësimore. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.17 RREGULLORJA E KËSHILLIT STUDENTOR.pdf</i> <i>Shtojca 1.19 Kodi i etikës së UNIKO.pdf</i> <i>Takimi me stafin dhe vizita në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga takimi me studentët GVJ konstaton se programi i studimit “Informatikë Biznesi” garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim të tij, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Statutin dhe rregulloret e institucionit. Studentët informohen mbi rezultatet përmes sistemit elektronik “Pitagora”, si dhe kanë të drejtë të kërkojnë sqarim apo të ankimojnë rezultatin në rast të mosmarrëveshjeve. Ankesa bëhet me shkrim pranë Drejtuesit të Njesisë Kryesore, brenda ditës për provimet me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim, duke garantuar një proces transparent dhe të drejtë. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>

	<i>Takimi në institucion me studentët dhe stafin akademik</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga takimet në institucion me studentët dhe stafin akademik në programin e studimit “Informatikë Biznesi” në UNIKO ka të formalizuara dhe funksionale procedurat për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të studentëve në lidhje me vlerësimin. Bazuar në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë, çdo ankesë shqyrtohet fillimisht nga Dekani, i cili organizon një seancë sqaruese me pjesëmarrjen e përgjegjësit të departamentit, komisionit të provimit dhe studentit. Vendimi merret brenda dy ditëve dhe është i formës së prerë. Në rast se ankesa vlerësohet e drejtë, provimi përsëritet me një komision të ri, brenda një afati maksimal prej 5 ditësh nga përfundimi i sezonit. Procedura dokumentohet dhe arkivohet nga njësitë përkatëse. Nuk ka pasur raste në këtë program të ankesa për marrjen e masës së përsëritjes së provimi. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Shtojca 1.17 RREGULLORJA E KËSHILLIT STUDENTOR.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se në programin Bachelor në “Informatikë Biznesi” realizohet një proces i strukturuar, transparent dhe i bazuar në meritë për testimin dhe vlerësimin e studentëve.</i> <i>Janë të zbatueshme praktika të mirëpërcaktuara për vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar, si dhe për trajtimin e ankesave dhe rishikimin e rezultateve. Përdorimi i platformave dixhitale rrit transparencën dhe sigurinë e vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive

thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	profesionale dhe të veçanta të studentëve, në përputhje me objektivat e programit dhe kërkesat e tregut të punës. Përmes një kurrikule të strukturuar dhe të përditësuar, lëndëve teorike dhe praktike, si dhe mundësisë për realizimin e seminareve në laboratore, praktikës profesionale dhe përgatitjes së temës së diplomës, studenti përgatitet për role të ndryshme profesionale në fushat ndërdisiplinare të ekonomisë dhe inomatike për biznese dhe kompani të ndryshme. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Takimet me studentët dhe stafin</i> <i>Faqe web e programit te studimit:</i> <i>https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fe&tipi=ba&programi=insbiz</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	GVJ konstaton se programi i studimit “Informatikë Biznesi” garanton zhvillimin e aftësive të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes moduleve praktike dhe teorike si “Programim Java”, “Teknologji Web”, “Algoritmikë” dhe “Sisteme të menaxhimit të bazës së të dhënave”. Gjithashtu, zhvillimi i aftësive në shkencat humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit mbështetet përmes lëndëve si “Komunikimi në biznes”, “Ligje për informaticienët e biznesit” dhe “Gjuhë e huaj”. GVJ vlerëson se përmbajtja e kurrikulës dhe infrastruktura mësimore sigurojnë përmbushjen e këtij kriteri në mënyrë të plotë. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe	GVJ konstaton se në programin e studimit “Informatikë Biznesi”, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti janë të përcaktuara qartë në syllabuset e çdo lënde, të përfshira në programet mësimore për vitet akademike përkatëse (Aneksi

syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	II.16/2022–2023, 2023–2024 dhe 2024–2025). Në këto syllabus janë pasqyruar objektivat formues dhe rezultatet e të nxënit për çdo modul, të cilat lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencave profesionale, shkencore dhe të aplikueshme në fushën e informatikës së biznesit. Pedagogët, në përfundim të lëndës, informojnë studentët mbi arritjet e tyre dhe ofrojnë këshillim për përgatitjen në provimet përfundimtare. Gjithashtu, përmes detyrave të kursit, projekteve dhe pjesëmarrjes aktive gjatë semestrit, studentët përfshihen në një proces të vazhdueshëm reflektimi dhe përmirësimi të aftësive të tyre. GVJ vlerëson se ky kriter përmbushet plotësisht në këtë program studimi. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ konstaton se në programin e studimit “Informatikë Biznesi”, mësimdhënia është ndërtuar mbi bazë kompetencash që synojnë zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike të studentëve, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe objektivat e programit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit (programet lëndore, planifikimet mësimore, raportet e praktikës profesionale) dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët, u evidentua se procesi mësimor ndërthur leksionet teorike me punë praktike në laborator, realizimin e detyrave dhe projekteve në grup, analiza rastesh konkrete, si dhe praktika profesionale në fund të ciklit trevjeçar. Stafi akademik mbështet aktivisht punën në grup, diskutimet dhe zgjidhjen e çështjeve praktike, duke nxitur mendimin kritik dhe ide inovative. Gjithashtu, bashkëpunimi me institucione publike dhe private u mundëson studentëve kryerjen e praktikës profesionale dhe lidhjen e njohurive teorike me përvojën reale në sektorin e informatikës së biznesit. GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>

	<i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit “Informatikë Biznesi”, si efektiv ashtu edhe me kontratë, angazhohet në organizimin dhe realizimin e leksioneve të hapura dhe seminareve mbi zhvillime të reja në shkencë dhe teknologji, duke pasuruar përmbajtjen akademike përtej kurrikulës bazë. Këto aktivitete përfshijnë bashkëpunim me ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve publike dhe bizneseve private, dhe synojnë të informojnë studentët mbi prirjet më të fundit në teknologji dhe informatizimin e proceseve të biznesit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe raportet vjetore të departamentit dhe fakultetit (Aneksi II.21), si dhe nga takimi i GVJ me stafin akademik, u konfirmua zhvillimi i tryezave të rumbullakta, workshopeve dhe aktiviteteve të tjera konsultative. GVJ vlerëson se përmbajtja e këtyre aktiviteteve ndihmon në forcimin e lidhjes së programit me zhvillimet aktuale në tregun e punës dhe në rritjen e cilësisë së formimit profesional të studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit “Informatikë Biznesi” përmbush në mënyrë të plotë standardin që lidhet me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke garantuar zhvillimin e njohurive të avancuara dhe kompetencave profesionale të studentëve. Kurrikula është e strukturuar në mënyrë të tillë që integron mësimin teorik me përvojën praktike, përmes praktikave profesionale, punës në laborator dhe projekteve konkrete. Procesi mësimor mbështetet në metodologji bashkëkohore dhe në një staf akademik të angazhuar që promovon ide inovative dhe kërkime të aplikuara. Gjithashtu, organizimi i aktiviteteve akademike jashtë strukturës formale të programit, si seminare, laboratore dhe leksione të hapura, kontribuon në zgjerimin e



	<i>horizonteve të studentëve dhe përshtatjen me kërkesat dinamike të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	GVJ konstaton se programi i studimit “Informatikë Biznesi” ndjek një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për detyrimet përmbyllëse të studentëve, të cilat përmbledhen në përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Këto procedura janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë (Kreu V, Neni 39 – Aneksi I.28), Rregulloren e Programit të Studimit (Seksioni 9 – Aneksi II.11), si dhe në Udhëzuesin për përgatitjen e temës së diplomës (Aneksi II.07), të hartuar nga Departamenti i Menaxhimit. Ky udhëzues publikohet për studentët përpara fillimit të procesit të diplomimit dhe është lehtësisht i aksesueshëm në zyrën e informimit të studentit si dhe në faqen zyrtare të UNIKO. GVJ vlerëson se kjo transparencë dhe qartësi në procedura ndihmon studentët të përgatiten në mënyrë të strukturuar dhe të sigurt drejt përfundimit të programit të tyre të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Takimet me studentët dhe stafin akademik</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli	GVJ konstaton se në programin e studimit “Informatikë Biznesi”, strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik



akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	asistojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët në përmbushjen e detyrimeve përfundimtare. Udhëzimet dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e temës së diplomës janë të dokumentuara në Udhëzuesin për Diplomën dhe Rregulloren e Programit të Studimit, ku përcaktohen temat e diplomës dhe pedagogët udhëheqës. Gjithashtu, Zyra e informimit të studentëve dhe Sekretaria e Departamentit informojnë dhe orientojnë studentët përmes afishimeve dhe njoftimeve mbi afatet, kriteret dhe procedurat përkatëse. Studentët kanë në dispozicion burime të vlefshme si biblioteka fizike dhe online, si dhe laboratorë të informatikës për të mbështetur punën e tyre kërkimore dhe praktike. GVJ vlerëson se ky bashkërendim institucional ndihmon në sigurimin e cilësisë dhe përgatitjes së duhur të punimit përfundimtar të studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.7 UDHËZUES - PUNIM DIPLOME.pdf</i> <i>Takimet me studentët dhe stafin akademik</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ konstaton se në programin e studimit “Informatikë Biznesi” është e përcaktuar një procedurë e qartë për administrimin e provimit përfundimtar, i cili realizohet përmes një komisioni të posaçëm që teston njohuritë e marra nga studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. Ky vlerësim përfshin përmbajtje nga të gjitha lëndët/modulet, duke u bazuar në rëndësinë dhe peshën e tyre specifike në formimin profesional të studentit. Procesi i diplomimit mbështetet nga struktura të ndryshme të institucionit si: drejtuesi i njësisë bazë që monitoron dhe informon; Zyra e Informimit dhe Orientimit e cila ofron Udhëzuesin e diplomës dhe asiston në depozitimin e punimeve dhe prezantimeve në Pitagora; si dhe Sekretaria Mësimore që afishon të gjithë informacionin përkatës mbi afatet dhe detyrimet. GVJ vlerëson se ky bashkëpunim institucional siguron një proces transparent, të rregullt dhe gjithëpërfshirës të diplomimit. <i>Referenca:</i> https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/INFORMIM-I-PERGJITHSHEM-PER-VITET-E-PARA.pdf https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/05/Manual-per-studente-per-sistemin-Pitagora-fund.pdf
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe	GVJ vëren se në programin “Informatikë Biznesi”, personeli akademik dhe udhëheqësi i diplomës luajnë një rol kyç në orientimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë përgatitjes së

ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	punimit të diplomës. Udhëheqësi i diplomës përcakton një grafikun të rregullt konsultimesh, ku monitorohet dhe vlerësohet progresi i punës së studentit, duke i ofruar udhëzime të detajuara mbi strukturën, përmbajtjen, metodologjinë dhe elementët formalë të punimit. Ai siguron cilësinë e punimit duke rishikuar materialin e dorëzuar dhe duke miratuar paraprakisht para mbrojtjes, duke plotësuar formularin e vlerësimit përkatës. Kjo praktikë është konfirmuar edhe gjatë takimeve të GJVJ me stafin akademik dhe studentët, duke dëshmuar një proces të strukturuar dhe mbështetës për suksesin akademik të studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 3.3 FORMATI I VLERËSIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS NGA OPONENTI, UDHËHEQËSI I TEMËS DHE KRITERET E VLERËSIMIT .pdf</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga vizita në laboratore, ambjentet e bibliotekës, dhe takimet me stafin u konfirmua se gjatë përgatitjes të punimit të diplomës, studenti mund të shfrytëzojë bibliotekën e fakultetit, bibliotekën online, si dhe laboratorët e informatikës. Në takim studentët dhe alumni, u shprehën pozitivisht për mbështetjen institucionale, nëpërmjet shfrytëzimit të mjediseve të institucionit, si dhe asistencës nga stafi akademik gjatë gjithë procesit të përgatitjes së temës diplomës. <i>Referenca:</i> <i>Takimet dhe vizita në institucion</i> <i>RVB BA IB.pdf</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga takimet në institucion me strukturuar drejtuese dhe referuar, Rregullores të njësisë kryesore/bazë dhe Rregullores së Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës bëhet përpara një komisioni, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani. Studenti prezanton punimin e diplomës para Komisionit të Diplomimit. Në përfundim të mbrojtjes së temës së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Në vlerësimin e temës diplomës, merret parasysh vlerësimi i udhëheqësit të temës, i oponentit dhe komisionit, të cilët gjykojnë dobinë e punimit dhe zbatimin praktik të tij; cilësinë e prezantimit; përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve; si dhe arritjet akademike të studentit, gjatë ciklit të studimit.



	<i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Rregulloret e njësisë kryesore/bazë si edhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, përcaktojnë se studenti pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet përkatëse, pajiset me diplomë Bachelor në “Informatikë Biznesi”. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin e diplomës, sipas modelit të miratuar nga MAS. Sipas kërkesës së tyre, studentëve i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e dokumentacionit e nënshkruar nga Dekani i Fakultetit dhe drejtuesi i njësisë bazë, për programin e studimit që kanë kryer. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>RVB BA IB.pdf</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në dokumentacione e dorëzuar, vizitës në Sekretarinë Mësimore dhe në zbatim të kriterëve dhe udhëzimeve të MAS, diploma për programin e studimit, Bachelor në “Informatikë Biznesi”, është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore të MAS. Sekretaria dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës për secilin student, që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike. Dokumentacioni në hard copy, ruhet dhe administrohet nga sekretaria mësimore e fakultetit dhe në formë elektronike në sistemin Pitagora. <i>Referenca:</i> <i>Dokumentacionin në AMS: Urdhër Nr.402, datë 2018-07-12, Urdhër Nr.51, datë 2022-03-15</i> <i>Vizitat në Sekretarinë Mësimore</i>

Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi" ka procedura të qarta dhe të dokumentuara për detyrimet përmbyllëse të studentëve, të aksesueshme dhe transparente. Personeli akademik dhe strukturat përkatëse ofrojnë mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.</i> <i>Procesi i diplomimit realizohet nga komisione profesionale që vlerësojnë njohuritë dhe punën e studentëve në mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Pas përfundimit të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe dokumentacionin zyrtar, ndërsa institucionit ruan dhe administron me kujdes të gjithë dokumentacionin në përputhje me legjislacionin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën	Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi – përkatësisht neneve 57, 59 dhe 66 të Ligjit nr. 80/2015, neneve 41 dhe 48 të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, si dhe neneve 27 dhe 36 të Rregullores së brendshme të UNIKO-s- dhe duke iu referuar RVB-së, Fakulteti Ekonomik garanton se stafi akademik i përfshirë në program mbulon me kompetencë lëndët dhe modulet përkatëse. Ky staf zotëron përvojë të konsiderueshme akademike dhe profesionale, në përputhje me kërkesat e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi".

kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Grada/tituj	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.Asoc.	8		9	-	8	-
Dr./PhD	12	1	12	3	12	1
MSc	4	4	5	2	4	4
Total	24	5	26	5	24	5

Referenca

Ligj Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT ‘FAN S. NOLI’.pdf

Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf

Aneksi 2.19 CV - STAFI AKADEMIK - PROGRAMI I STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf

Aneksi 4.1 CV E PERSONELIT NDIHMËS AKADEMIK.pdf

Aneksi 5 +TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS;

<https://unkorce.edu.al/departamenti-i-menaxhimit/>

Aneksi 4.2 NIVELI I KUALIFIKIMIT TE PERSONELIT AKADEMIK FAKULTETI I EKONOMISË.pdf

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Ky program ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit, në kuadër të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Korçës, dhe është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të këtij fakulteti, i cili mban përgjegjësinë për zbatimin e tij. Departamenti është i organizuar në përputhje me kërkesat e nenit 25, pika 4, të Ligjit nr. 80/2015. Në përbërje të këtij departamenti janë gjithsej 9 staf akademik (PAE), nga të cilët 89% mbajnë tituj akademikë ose grada shkencore. Konkretisht, stafi përbëhet nga 4 profesorë të asociuar, 4 doktorë shkencash dhe 1 kandidat në proces doktrature. Përballimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik, në 3 vitet e fundit, paraqitet si vijon:

Viti akademik	PAE (%)	PAK (%)
2022 - 2023	91 %	9 %
2023 - 2024	91 %	9 %
2024 - 2025	97 %	3 %

	<i>Referenca:</i> <i>Ligj Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Aneksi 1.30 TË DHËNA PËR PERSONELIN AKADEMIK QË MBULON DISIPLINAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vëren se ekziston qëndrueshmëri në trupën akademike të angazhuar përgjatë gjithë periudhës së akreditimit, si në aspektin e marrëdhënieve të punës me kontrata të pacaktuara, ashtu edhe në përmbushjen e detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimin në burim mbi të ardhurat nga punësimi. Në përputhje me nenet 57 pika 2 dhe 59 të Ligjit nr. 80/2015, si dhe me përcaktimet e VKM nr. 329, datë 12.04.2017 dhe nenet 39 dhe 41 të Statutit të UNIKO, nuk janë evidentuar shkelje të kuadrit ligjor përkatës gjatë kontrollit të ushtruar në institucion, përfshirë shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik. Të gjitha këto aspekte janë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"; si dhe me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.19 CV - STAFI AKADEMIK - PROGRAMI I STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 1.31 TË DHËNA PËR PERSONELIN AKADEMIK TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 1.30 TË DHËNA PËR PERSONELIN AKADEMIK QË MBULON DISIPLINAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Shtojca 1.4 RREGULLORJA E DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE.pdf</i> <i>Aneksi 4.6 MODELI I KONTRATËS INDIVIDUALE TË PUNËS.pdf</i>

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Veprimtaria rekrutuese në Universitetin “Fan S. Noli” (UNIKO) zhvillohet në përputhje me parimet e transparencës, paanshmërisë dhe barazisë në konkurrim, në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe Rregullores së brendshme të institucionit. Kriteret e përgjithshme për konkurset publike përcaktohen nga Rregullorja, ndërsa ato specifike hartohen nga njësitë bazë dhe miratohen nga rektori. Për çdo vend vakant, shpallet një konkurs publik, i cili ndiqet nga një Komision Ad Hoc që shqyrton dokumentacionin dhe vlerëson përputhshmërinë me kriteret përkatëse. Drejtorja Juridike dhe Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për të ndjekur të gjitha hapat e procesit të rekrutimit: nga shpallja e vendit vakant, mbledhja e dokumentacionit, ngritja e komisioneve përkatëse, zhvillimi i konkursit, deri te vlerësimi përfundimtar dhe njoftimi i kandidatëve. Kandidatët vlerësohen në bazë të kriterëve të përcaktuara në vendimin e rekrutimit, ku përparësi u jepet specialitetit të diplomës dhe notës mesatare. Në rast barazie pikësh, avantazhohen kandidatët me diploma nga universitete të njohura të vendeve të OECD ose me nota më të larta. Pas përfundimit të konkursit dhe shpalljes së fituesit, lidhja e marrëdhënies së punës formalizohet përmes kontratës individuale të punës, e cila nënshkruhet nga kandidati dhe Rektori. Për rekrutimin e pedagogëve me kohë të pjesshme, procedura nis me diskutime në nivel departamenti, ku shqyrtohet ngarkesa mësimore dhe përcaktohen kriteret e pranimi bazuar në specialitet, disiplinë dhe kualifikim profesional. <i>Referenca:</i> <i>Ligj Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT ‘FAN S. NOLI’.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Shtojca 1.4 RREGULLORJA E DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE.pdf</i> <i>Aneksi 4.7 FORMATI I SHPALLJES SË VENDIT VAKANT STAF AKADEMIK.pdf</i> <i>Aneksi 4.8 FORMATI I VENDIMIT TE REKTORIT PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC.pdf</i> <i>Aneksi 4.9 FORMAT URDHËR EMËRIMI.pdf</i> <i>Aneksi 4.10 KRITERET E PRANIMIT DHE PËRZGJEDHJES TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TE PJESSHME.pdf</i>
---	---

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në RVB institucioni nuk angazhon personel ndihmës akademik në realizimin e orëve mësimore që zhvillohen në laboratore. <i>Referenca</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Aneksi 2.2 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore në UNIKO është njësi përgjegjëse për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe kontratave individuale të punës për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Kjo drejtori ka për detyrë të monitorojë afatet përkatëse të kontratave dhe të sigurojë përputhshmërinë me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe me rregulloret përkatëse të brendshme të institucionit. Në përmbushje të këtij funksioni, drejtorja kujdeset për ruajtjen e kopjeve fizike dhe elektronike të kontratave të punës, duke garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e informacionit të përmbajtur në to. Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë përcakton detyrat specifike të saj në këtë drejtim, veçanërisht në nenin 4, pika d dhe nenin 7, pika 8. Baza e të dhënave që administrohet nga kjo drejtori përfshin dokumentacion të gjerë dhe të detajuar për personelin, si: dosjet personale, organikën e Fakultetit Ekonomik, CV-të, marrëveshjet për organizimin e kohës vjetore, formularët e ngarkesës mësimore, syllabuset, regjistrat e pedagogëve dhe dokumente të tjera të përcaktuara në udhëzimin përkatës (Kreu I, pika 3).
	<i>Referenca:</i> <i>Shtojca I.09 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe perpunimin e të dhënave personale</i> <i>Shtojca I.04 Rregullorja e drejtorisë juridike dhe burimeve njerëzore</i> <i>Shtojca 1.14 Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrative</i> <i>Aneksi 2.19 CV - STAFI AKADEMIK - PROGRAMI I STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>

	<i>Aneksi 4.1 CV E PERSONELIT NDIHMËS AKADEMIK.pdf</i> <i>Aneksi 4.11 FORMATI I ORGANIZIMIT TË KOHES VJETORE TË PUNËS.pdf</i> <i>Aneksi 4.12 FORMATI I RREGJISTRIT TË PEDAGOGUT.pdf</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar në nenin 38 të Rregullores së Fakultetit Ekonomik (FE) dhe seksionit 9 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit, UNIKO, përmes FE-së dhe këtij departamenti, ka formalizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është krijimi i mundësive për studentët që të zhvillojnë praktika profesionale dhe të angazhohen në aktivitete që lidhen me fushën e tyre të studimit. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, institucioni angazhon staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të udhëhequr dhe mbikëqyrur studentët gjatë praktikave, për hartimin e diplomës si dhe për aktivitete të tjera akademike që ndihmojnë në zhvillimin e tyre profesional. Kjo mbështetje garanton një ndërlidhje efektive ndërmjet teorisë dhe praktikës në arsim. <i>Referenca</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 1.34 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS FE DHE UNIVERSITETEVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA.pdf</i> <i>Aneksi 1.35 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT DHE BIZNESIT PRIVAT.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Aneksi 2.6 UDHËZUES PRAKTIKE.pdf</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e	Në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet UNIKO, Fakultetit Ekonomik dhe institucioneve partnere, studentëve u jepet mundësia të përfitojnë nga përvoja dhe njohuritë praktike të profesionistëve të fushës. Këto bashkëpunime synojnë të përmirësojnë përgatitjen e tyre profesionale dhe t'i pajisin me aftësitë e nevojshme për një përballje më të suksesshme me tregun e punës. Sipas RVB, si dhe të dhënave të mbledhura gjatë vizits në institucionin e arsimit të lartë, personeli mbikëqyrës i angazhuar në vendet e praktikës luan një rol aktiv në procesin formues të studentëve.



vlerësimi të tyre për praktikën profesionale.	<i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.36 RELACIONE PËR PËRFITIMET NGA PRAKTIKA PROFESIONALE.pdf</i> <i>Aneksi 2.6 UDHËZUES PRAKTIKE.pdf</i> <i>Aneksi 1.34 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS FE DHE UNIVERSITETEVE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA.pdf</i> <i>Aneksi 1.35 MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMI MIDIS DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT DHE BIZNESIT PRIVAT.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, në përfundim, konkludon se për programin Bachelor në "Informatikë Biznesi" personeli akademik dhe ndihmës përmbush plotësisht kërkesat ligjore për kualifikimin dhe eksperiencën, ndërsa ngarkesa mësimore mbulohet sipas kuadrit ligjor. Institucioni garanton qëndrueshmëri të personelit përmes kontratave të rregullta dhe sigurimeve përkatëse.</i> <i>Rekrutimi dhe vlerësimi i personelit bazohet në kritere të qarta dhe transparente, të përputhshme me natyrën e programit. Po ashtu, institucioni administron dhe përditëson rregullisht të dhënat e personelit sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave, dhe siguron staf të kualifikuar për mbështetjen e studentëve në praktikat profesionale dhe punimin e diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në	Fakulteti Ekonomik (FE) disponon një infrastrukturë të përshtatshme dhe të mirëorganizuar fizike, didaktike dhe logjistike, e cila mbështet në mënyrë efektive zhvillimin e programit të studimit. Auditorët, laboratorët, ambientet e dedikuara për stafin akademik dhe ndihmës, si dhe biblioteka, ofrojnë kushte optimale për realizimin cilësor të procesit mësimor. Këto ambiente përmbushin standardet për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe aktiviteteve të tjera akademike,

përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	duke garantuar kushte të favorshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Infrastruktura fizike është e mirëorganizuar dhe funksionale, duke mundësuar shfrytëzimin optimal të saj nga studentët dhe stafi akademik. Në fillim të çdo semestri, hartohet një orar mësimor i detajuar, ku përcaktohen mjediset specifike për zhvillimin e lëndëve, në përputhje me numrin e studentëve dhe natyrën e moduleve. Kjo qasje siguron përdorim efikas të hapësirave dhe ndihmon në organizimin e një procesi mësimor të qartë dhe të strukturuar. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 4.13 KAPACITETET INFRASTRUKTURE TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Shtojca 1.15 Raport i kontrollit të MAS për kapacitete pritëse.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Programi i studimit dhe veprimtaria akademike e njësisë bazë dhe asaj kryesore zhvillohen në “Godinën e Fakultetit të Ekonomisë”, e cila ka kaluar një rikonstruksion të plotë me qëllim përmirësimin e kushteve për studentët dhe stafin. Investimet kanë synuar krijimin e një ambienti modern, funksional dhe në përputhje me nevojat bashkëkohore të procesit mësimor. Gjatë vizitës në terren nga GVJ, u konstatua se sallat e leksioneve janë të pajisura me teknologji të avancuar, e cila mbështet përdorimin e metodave moderne të mësimdhënies. Pajisjet teknologjike janë gjithashtu të aksesueshme për studentët dhe përdoren për prezantimin e detyrave të kursit, projekteve praktike dhe temave të diplomës, duke nxitur një mjedis interaktiv dhe bashkëkohor të të nxënit. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 4.13 KAPACITETET INFRASTRUKTURE TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të	Në funksion të përgatitjes teorike dhe praktike të studentëve, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Menaxhimit bashkëpunon ngushtësisht me Departamentin e Informatikës, që vepron në kuadër të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Ky bashkëpunim përfshin hartimin e përbashkët të kurrikulës, zhvillimin dhe përditësimin e

përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	moduleve teknologjike, si dhe përfshirjen e stafit akademik të specializuar në fushën e informatikës në procesin mësimor. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, studentët përfitojnë nga ndarja e burimeve laboratorike, Disiplinat që zhvillohen në këto laboratorë përfitojnë drejtpërdrejt nga ky bashkëpunim ndërdepartamental, duke garantuar një përgatitje të integruar dhe bashkëkohore për studentët. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 4.13 KAPACITETET INFRASTRUKTURE TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni i arsimit të lartë garanton funksionimin e një laboratorit të teknologjisë së informacionit, të pajisur me 30 kompjutera dhe me programe profesionale që i përgjigjen natyrës së programit të studimit, Laboratori shfrytëzohet nga studentët për zhvillimin e disiplinave teknologjike si Informatika e Biznesit, E-biznes, Komunikimi në Biznes, etj., duke siguruar mbështetje konkrete për përvetësimin e aftësive praktike dhe teknologjike. <i>Referenca:</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Aneksi 4.13 KAPACITETET INFRASTRUKTURE TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ, në përfundim, konkludon se për programin Bachelor në "Informatikë Biznesi" institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe funksionale, të përshtatura me numrin e studentëve dhe natyrën e moduleve, duke garantuar zhvillimin optimal të veprimtarisë mësimore.</i> <i>Mjediset mësimore janë të pajisura me teknologji bashkëkohore dhe mjete elektronike që mbështesin në mënyrë efektive procesin teorik dhe praktik të mësimdhënies-mësimnxënies.</i> <i>Laboratorët dhe ambientet praktike janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për realizimin e objektivave të programeve të studimit dhe aftësimin e studentëve. Institucioni garanton një laborator të teknologjisë së</i>

	<i>informacionit të pajisur me programe profesionale, në përputhje me kërkesat specifike të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar RVB-së, UNIKO siguron akses të plotë në Bibliotekën Shkencore për studentët dhe personelin akademik të të gjitha fakulteteve, me një fond prej 4071 librash dhe 1265 titujsh. Veçmas, Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë disponon një koleksion prej 5316 librash dhe 3610 titujsh, me literaturë në gjuhën shqipe (226 libra) dhe në gjuhë të huaja (5090 libra), duke mbuluar në mënyrë të plotë nevojat akademike të studentëve. Ambientet e bibliotekës janë të mirëmbajtura dhe krijojnë kushte të favorshme për studim individual. Në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik është dhe biblioteka digjitale. Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se studentëve u vihet në dispozicion i gjithë materiali i nevojshëm mësimor, përfshirë programin lëndor dhe literaturën përkatëse, e ofruar nga vetë lektorët e lëndëve. Kjo siguron mbështetje të vazhdueshme për përvetësimin e dijeve të parashikuara në programin e studimit. <i>Referenca:</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Aneksi 4.14 FONDI I BIBLIOTEKËS TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Referuar aneksit 4.14 fondi i bibliotekës të UNIKO dhe FE dhe RVB-së, UNIKO ka ndërmarrë hapa konkretë për pasurimin e fondit të bibliotekës, në përputhje me Urdhërin Nr. 39, datë 25.01.2019, të rektorit, dhe përmes sigurimit të donacioneve të ndryshme. Këto masa janë ndërmarrë në përgjigje të kërkesave të stafit pedagogjik, njësive bazë dhe studentëve, duke marrë

	në konsideratë gjendjen aktuale të bibliotekës dhe buxhetin e miratuar për Fakultetin e Ekonomisë. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, më 12.04.2024, Bibliotekës së Fakultetit të Ekonomisë i është shtuar një fond i ri prej 14 librash, përmes një akti dhurimi nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”. Kjo nismë përfaqëson një hap pozitiv në drejtim të përmirësimit të aksesit në literaturë dhe mbështetjes akademike për studentët dhe stafin. <i>Referenca:</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Aneksi 4.14 FONDI I BIBLIOTEKËS TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë (FE) mbështet drejtpërdrejt procesin mësimor, edukativ, formimin profesional dhe veprimtarinë shkencore të zhvilluar në fakultet. Ajo është e pajisur me 3 kompjutera, lidhje interneti dhe sistem ngrohjeje, çka krijon kushte komode për lexim dhe punë individuale. Studentët kanë mundësi të huazojnë libra pa pagesë, si dhe të përdorin ambientet për qëllime studimi. Gjithashtu, Biblioteka Shkencore pranë Rektoratit mbetet e hapur edhe për komunitetin e gjerë, duke rritur më tej aksesin në literaturë akademike. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 4.13 KAPACITETET INFRASTRUKTURE TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Aneksi 4.14 FONDI I BIBLIOTEKËS TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	UNIKO ofron akses të plotë në Bibliotekën Shkencore atë të Fakultetit të Ekonomisë dhe atë të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane të cilat përmbajnë një fond të pasur librash në gjuhën shqipe dhe të huaj. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se studentëve u vihet në dispozicion i gjithë materiali i nevojshëm mësimor, përfshirë programet lëndore dhe literaturën përkatëse, gjë që siguron mbështetje të vazhdueshme për përvetësimin e dijes. UNIKO ka mundur aksesin në Bibliotekën Online për studentët dhe stafin akademik, si pjesë e iniciativës për digjitalizimin e bibliotekës, në kuadër të Planit Strategjik të Universitetit 2022–2027. Përmes platformës U-Library,




specifikës së programit të studimit.	përdoruesit mund të lexojnë dhe shkarkojnë materiale pa pagesë, duke u regjistruar me adresën zyrtare të email-it në faqen e universitetit. Ky shërbim ofron një fond të pasur me mbi 170,000 libra, 70 milion artikuj akademikë, artikuj gazetash, harta dhe mjete audiovizive. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 4.14 FONDI I BIBLIOTEKËS TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë drejtohet nga një punonjës i kualifikuar dhe trajnuar për të përmbushur në mënyrë efikase të gjitha funksionet e saj. Ajo shërben njëkohësisht si sallë studimi me fonde të hapura, është e pajisur me 3 kompjutera, internet dhe sistem ngrohjeje, dhe ofron 40 vende ulje, duke krijuar kushte komode për lexim dhe studim. Studentët kanë mundësi të huazojnë libra pa pagesë dhe të shfrytëzojnë ambientet për studim, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e literaturës është gjithashtu e aksesueshme në Bibliotekën Shkencore pranë Rektoratit, e cila frekuentohet edhe nga komuniteti dhe në atë të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 4.13 KAPACITETET INFRASTRUKTURE TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Aneksi 4.14 FONDI I BIBLIOTEKËS TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	UNIKO ofron një gamë të gjerë burimesh bibliotekare për studentët dhe personelin akademik, duke përfshirë biblioteka fizike të pajisura me kompjutera, fotokopje, internet dhe sistem ngrohjeje, si dhe shërbime të avancuara të bibliotekës digjitale. Përmes platformës ULibrary dhe projekteve si Clean Score (me akses falas në J-Store), studentët dhe stafi kanë qasje në mbi 170,000 libra, 70 milion artikuj akademikë, si dhe mjete audiovizive e materiale sipas disiplinave të programit të studimit. Për më tepër, përmes përfshirjes në rrjete ndërkombëtare si COBISS UNIKO siguron pasurimin dhe aksesin e vazhdueshëm në literaturë cilësore për të gjithë përdoruesit e saj, brenda dhe jashtë institucionit.

	<i>Referenca:</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>https://unkorce.edu.al/sites/default/files/Manual_JSTOR%20UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 4.13 KAPACITETET INFRASTRUKTURE TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Aneksi 4.14 FONDI I BIBLIOTEKËS TË UNIKO DHE FE.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë është funksionale nga dita e hënë deri të premten, në orarin 08:00–16:00, dhe oraret e saj janë të afishuara publikisht për lehtësinë e përdoruesve. Kjo bibliotekë ofron shërbime të strukturuar dhe të aksesueshme për të gjithë anëtarët e komunitetit universitar. Përdorimi i bibliotekës bëhet vetëm përmes kartelave të regjistrimit. Studentët dhe pedagogët zotërojnë kartela personale, ndërsa edhe personeli ndihmës akademik, administrativ dhe anëtarët e komunitetit mund të regjistrohen për të përfutur nga shërbimet e bibliotekës universitare. <i>Referenca:</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe	Bazuar në RVB, njësitë përgjegjëse e programit të studimit bashkëpunon rregullisht me bibliotekën për të evidentuar literaturën kryesore në funksion të moduleve të programit dhe për të përcaktuar nevojat për tituj të rinj. Ky bashkëpunim mundëson pasurimin e fondit të bibliotekës, si fizik ashtu edhe online, me botime bashkëkohore, duke garantuar që studentët të kenë në dispozicion literaturën e nevojshme dhe të përditësuar për përvetësimin e njohurive akademike. Për më tepër, në Planin Strategjik të Universitetit “Fan S. Noli”, konkretisht në Planveprimin për Objektivin 3, janë përcaktuar qartë disa masa për pasurimin e vazhdueshëm të fondit të librave, si në bibliotekën fizike, ashtu edhe në atë digjitale. Këto masa përfshijnë veprime të koordinuara ndërmjet njësive akademike dhe bibliotekës për të siguruar akses të gjerë dhe të lehtë në literaturë bashkëkohore, në përputhje me zhvillimet shkencore dhe kërkesat e programeve të studimi <i>Referenca:</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i>

për performancën e personelit akademik.									
Konkluzione	GVJ, në përfundim, konkludon se për programin Bachelor në “Informatikë Biznesi” literatura bazë dhe ndihmëse, në format fizik ose digjital, është e pranishme në gjuhën e programit dhe mbulon plotësisht objektivat mësimorë të programit të studimit. Institucioni ofron akses të barabartë në bibliotekën mësimore për të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka është e pajisur me fond të pasur fizik, në gjuhën shqipe dhe të huaj, që mbulon të gjitha modulet dhe veprimtaritë mësimore të programit. Studentëve u sigurohet përdorim i lirë dhe i barabartë në bibliotekat online të fushës përkatëse të studimit. Biblioteka është e pajisur me kompjuterë dhe pajisje teknike që mundësojnë akses të pakufizuar për studentët. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse monitorojnë vazhdimisht cilësinë dhe përditësimin e fondit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas RVB-së, UNIKO disponon sisteme të integruara informacioni, të cilat funksionojnë si pjesë e projektit RASH. Ky sistem ka si qëllim menaxhimin gjithëpërfshirës të informacionit dhe mundëson mbledhjen e të dhënave të ndryshme që lidhen me mësimdhënien, studentët, kërkimin, burimet njerëzore dhe aspekte të tjera. UNIKO ka nënshkruar një marrëveshje me RASH për përdorimin e sistemit elektronik PITAGORA. <i>Referenca:</i> FINAL RVB. BA IB LINK.pdf Shtojca 1.6 MARRËVESHJA ME RASH PËR SISTEMIN ELEKTRONIK PITAGORA.pdf




	<i>Shtojca 1.6.1 MANUAL I SISTEMIT ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Përmes sistemit elektronik Pitagora, administrohet i gjithë informacioni lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre, duke përfshirë regjistrimin e studentëve në programet e studimit, transferimin e tyre, faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave dhe bazën e të dhënave të diplomimit. Ky sistem gjithashtu menaxhon dokumentacionin e hartuar nga pedagogët lidhur me vlerësimin e studentëve, si vlerësimi i vazhduar dhe provimi përfundimtar. Për më tepër, sistemi Pitagora siguron akses të dedikuar dhe është i mbrojtur nga ndërhyrjet e paautorizuara, duke garantuar sigurinë dhe integritetin e informacionit. Sistemi mundëson gjithashtu monitorimin e aktiviteteve akademike dhe administrative nga drejtuesit dhe titullarët e institucionit përmes raporteve që krijohen automatikisht, duke mundësuar një mbikëqyrje efikase dhe të vazhdueshme të të gjitha proceseve. Për të lehtësuar informacionin dhe orientimin e studentëve, në hollin e godinës së fakultetit janë instaluar monitoret dhe stenda, ku paraqiten vazhdimisht njoftime dhe materiale informuese. Sistemi Pitagora ofron një sekretari elektronik të plotë për menaxhimin e të gjitha informacioneve lidhur me studentët, ndërsa regjistrat e pedagogëve kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit dhe ekipi i punës i ngritur nga Rektorati çdo vit akademik. Ky sistem përdoret nga studentët, pedagogët dhe sekretarët dhe ka integruar gjithashtu një sistem pagesash me bankë për tarifat dhe pagesat për shërbime. Për çdo përdorues, është hartuar një udhëzues për përdorimin e modulit përkatës. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.6 MARRËVESHJA ME RASH PËR SISTEMIN ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i> https://unk.pitagora.rash.al/ <i>Shtojca 1.6.1 MANUAL I SISTEMIT ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet	Sistemi Pitagora përdoret nga studentët dhe i gjithë personeli përmes një llogarie unike dhe fjalëkalimi. Manuali i Sistemit Elektronik Pitagora përshkruan mënyrën e përdorimit të sistemit nga çdo përdorues. Ky sistem ka të integruar edhe një sistem pagesash me bankë për tarifat dhe shërbimet, duke mundësuar menaxhim efikas të financave. Për sigurinë e të dhënave, Pitagora siguron akses të dedikuar dhe është i



personelit akademik dhe studentëve.	mbrojtur nga ndërhyrjet e paautorizuara, duke respektuar Ligjin Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". UNIKO ka miratuar një rregullore për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, e cila zbatohet për të gjitha të dhënat që përpunohen nga universiteti. Sistemi Pitagora është i lidhur me disa platforma që përmirësojnë cilësinë e mësimnxënies dhe lehtësojnë komunikimin ndërmjet personelit dhe studentëve. Moodle ofron mundësi për ndarjen e informacioneve, leksioneve, testeve online, diskutimeve dhe anketa. Pedagogët dhe studentët mund të hyjnë në Moodle duke përdorur kredencialet e sistemit Pitagora. Për studentët e programit "Informatikë Biznesi", është në dispozicion libraria digjitale U-LIBRARY, që mundëson akses në libra mësimorë, artikuj shkencorë dhe materiale të tjera në më shumë se 30 gjuhë të huaja. Po ashtu, është i disponueshëm dhe sistemi EBSCO dhe J-STORE për akses në revista shkencore. Për të mundësuar një komunikim më efikas, janë integruar edhe aplikacione të tjera eduMEET mundëson audio dhe videokonferenca për komunikim në kohë reale. Gjithashtu, janë të disponueshme Paketat Office 365 for Education, Google Meet dhe Google Classroom, të cilat ofrojnë mundësi bashkëpunimi dhe mësimdhënie online. Këto platforma mundësojnë akses të vazhdueshëm në çdo kohë dhe nga çdo vend përmes internetit, duke mbështetur procesin e mësimnxënies dhe komunikimit online. <i>Referenca</i> https://unk.pitagora.rash.al <i>Linku për aplikacionin që mundëson komunikimin interaktiv</i> https://unkorce.edu.al/lms-2/ Manuali mbi përdorimin e Moodle Manual mbi përdorimin e EDUMEET Manual mbi përdorimin e Google meet Manual përdorimin e Googleclassroom
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna	Sistemi i menaxhimit funksionon në mënyrë efektive, duke mundësuar monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Ky sistem siguron një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe ofron raporte të detajuara për organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit. Të dhënat që futen nga Fakulteti, Departamenti dhe personeli akademik (si programet lëndore, vlerësimi i vazhduar, vlerësimi përfundimtar, etj.) janë të disponueshme dhe vizibile në kohë reale, duke e bërë informacionin të aksesueshëm për studentët. Po ashtu, sistemi

në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	lejon monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ nga organet drejtuese dhe titullarët e institucionit përmes raporteve që gjenerohen automatikisht nga platforma. Kjo mundëson një menaxhim të centralizuar dhe efikas, duke siguruar që të dhënat janë të saktë dhe të përditësuara për vendimmarrje të informuar dhe transparente. <i>Referenca:</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Shtojca 1.6.1 MANUAL I SISTEMIT ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacioni për programin e studimit "Informatikë Biznesi", personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme është i publikuar në faqen web të UNIKO dhe në nënfaqen "Fakulteti i Ekonomisë". Kjo përfshin të dhëna për objektivat, organigramën, stafin akademik, departamentet, programet e studimit, infrastrukturën dhe aktivitete të tjera si botime, leksione dhe njoftime. Aktualisht, ky informacion është i disponueshëm vetëm në gjuhën shqipe. Gjatë kontrollit të faqes zyrtare të UNIKO (https://unkorce.edu.al/), u konstatua se informacioni për programin Bachelor në "Informatikë Biznesi" është në gjuhën shqipe, përfshirë planin mësimor dhe skedën e programit. Ndërkohë, skeda e programit është e përkthyer gjithashtu në gjuhën angleze, <u>GVJ sugjeron</u> që informacioni të parqitet gjithashtu dhe në një gjuhë angleze. <i>Referenca:</i> https://unkorce.edu.al/
Konkluzione	<i>GVJ, në përfundim, konkludon se për programin Bachelor në "Informatikë Biznesi" institucioni disponon një sistem të integruar menaxhimi që administron informacionin e studentëve dhe aktiviteteve të tyre, nga regjistrimi deri në diplomim.</i> <i>Sistemi menaxhon informacionin dhe dokumentacionin për personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe partnerët, duke ofruar akses të sigurt për të gjithë përdoruesit. Ai siguron monitorim të vazhdueshëm të aktiviteteve akademike dhe administrative dhe mundëson raportime për autoritetet drejtuese. <u>GVJ rekomandon</u> që informacionet mbi programin dhe personelin akademik të publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, përfshirë anglishten, për akses ndërkombëtar</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas statutit të UNIKO, hartimi dhe miratimi i buxhetit për universitetin nis nga njësitë bazë, për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi" nga Departamenti i Menaxhimit. Gjatë kësaj faze, merren parasysh nevojat financiare për realizimin e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Të dhënat lidhur me koston për student janë në rritje. Departamenti i Menaxhimit parashikon nevojat financiare për realizimin e programit të studimit dhe, pas miratimit në Dekanat, e paraqet atë në Rektorat. Administrata e Universitetit harton projekt-buxhetin për njësitë ndihmëse dhe, së bashku me projekt-buxhetet e njësive kryesore, përgatit buxhetin e vitit përkatës. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Aneksi 4.15 TË DHËNA LIDHUR ME KOSTO STUDENT PËR TRE VITET E FUNDIT.pdf</i> <i>Aneksi 4.16 FONDET E UK "GRANDI I BUXHETIT" & "TË ARDHURAT E KRIJUARA" REALIZIMI FAKTIK 4 VITET E FUNDIT.pdf</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën	Fazat e shpërndarjes së burimeve financiare: 1. Hartimi dhe miratimi i buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MAS bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga organet drejtuese të universitetit; 2. Buxheti nga të ardhurat e Universitetit, sipas nenit 88 të statutit të UNIKO, formulohet duke marrë parasysh të ardhurat e krijuara nga aktivitetet e tij; Në gjysmën e dytë të çdo viti, dhe në përputhje me nenin 87 të statutit, UNIKO realizon procedurat për miratimin e projekt-buxhetit afatmesëm. Ky buxhet mbështetet në kërkesat e njësive kryesore dhe ndihmëse dhe ndjek të njëjtën procedurë

dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	si ajo për miratimin e buxhetit vjetor. Bordi i Administratës siguron qëndrueshmërinë financiare të UNIKO, sipas statutit të universitetit. Miratimi i buxhetit afatmesëm për tre vjet dhe burimet e tij, si tarifatat e studentëve dhe granti i pakushtëzuar nga MAS, janë indikatorë të qëndrueshmërisë financiare të universitetit. UNIKO harton një plan financiar që përfshin ndarjen e burimeve sipas kategorive të ndryshme, përfshirë financimin e burimeve njerëzore (paga dhe shpërblime) shpenzimet operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe pasurimin e literaturës. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Aneksi 4.16 FONDET E UK "GRANDI I BUXHETIT"& " TË ARDHURAT E KRIJUARA" REALIZIMI FAKTIK 4 VITET E FUNDIT.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVB thekson se UNIKO respekton ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe, çdo vit, dorëzon pasqyrat financiare pranë MAS dhe Degës së Thesarit të Korçës. Universiteti i nënshtrohet auditimit financiar nga Auditi i Brendshëm i MAS dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe rezultatet e auditimit publikohen si në faqen zyrtare të universitetit, ashtu edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raporti i aktivitetit financiar diskutohet me organet kolegjiale të universitetit, përfshirë Rektoratin, Bordin e Administratës dhe Senatin Akademik, dhe është i disponueshëm për gjithë personelin dhe studentët e interesuar. <i>Referenca</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Raporti i veprimtarisë financiare të UNIKO përgatitet dhe diskutohet në mënyrë të rregullt me organet drejtuese, përfshirë Rektoratin, Bordin e Administrimit dhe Senatin Akademik. Ky raport garanton transparencë dhe mbetet i hapur për çdo anëtar të stafit apo student që është i interesuar të njihet me ecurinë financiare të institucionit. Përveç raportit financiar vjetor, në Rektorat dhe në Bordin e Administrimit shqyrtohen edhe dokumente të tjera të rëndësishme si raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), raporti i auditimit nga Ministria e Arsimit dhe ai i auditimit të brendshëm të Universitetit. Këto shqyrtime ndihmojnë në forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe mirëqeverisjes financiare. Gjithashtu, institucioni dokumenton në mënyrë të detajuar të ardhurat dhe burimet e



	financimit për secilin vit akademik, duke mbuluar një periudhë trevjeçare që përkon me përmbylljen e çdo cikli të plotë studimi. Kjo praktikë siguron pasqyrimin e plotë të burimeve dhe përdorimit të fondeve në funksion të objektivave akademike dhe zhvillimore të Universitetit. <i>Referenca</i> <i>FINAL RVB. BA IB LINK.pdf</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Aneksi 4.16 FONDET E UK "GRANDI I BUXHETIT" & " TË ARDHURAT E KRIJUARA" REALIZIMI FAKTIK 4 VITET E FUNDIT.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Planifikimi i shpenzimeve është thelbësor për funksionimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin afatgjatë të programit. Ky proces synon të menaxhojë në mënyrë efikase burimet financiare për të mbështetur zhvillimin dhe operimin e programit të studimit. Menaxhimi i mirëfilltë financiar është një faktor kyç për garantimin e standardeve akademike dhe operacionale. Për të siguruar zbatim të koordinuar dhe efektiv të buxhetit, parashikohet që të gjitha shpenzimet të realizohen nga një njësi e vetme shpenzuese, që vepron nën varësinë e Rektoratit. Kjo njësi ka përgjegjësinë për të mbikëqyrur zbatimin e kërkesave buxhetore të çdo njësie bazë, duke u siguruar që çdo shpenzim të jetë në përputhje me planin e miratuar dhe me strategjinë institucionale të universitetit. <i>Referenca</i> <i>Aneksi 4.16 FONDET E UK "GRANDI I BUXHETIT"& " TË ARDHURAT E KRIJUARA" REALIZIMI FAKTIK 4 VITET E FUNDIT.pdf</i>
Konkluzione	GVJ, në përfundim, konkludon se për programin Bachelor në "Informatikë Biznesi" institucioni ka hartuar raportin financiar dhe planin e mbështetjes financiare për një cikël të plotë studimi. Plani i financimit përfshin ndarjen e burimeve sipas kategorive të ndryshme, përfshirë financimin e burimeve njerëzore (paga dhe shpërblime), shpenzimet operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe pasurimin e literaturës. UNIKO kryen auditime periodike dhe vlerëson efektivitetin financiar. Institucioni dokumenton të ardhurat dhe financimet e ndryshme për tre vitet akademike në përmbyllje të çdo cikli të plotë studim. Për të siguruar menaxhim të efektshëm të shpenzimeve, zbatimi i buxhetit të kryhet nga një njësi e vetme shpenzuese, nën varësinë e Rektoratit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 dhe me Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", UNIKO ka përcaktuar në mënyrë të qartë politikat dhe procedurat që rregullojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit Bachelor "Infomatikë Biznesi", nga pranimi deri në përfundimin e studimeve. Rregullorja e Brendshme e Fakultetit Ekonomik përmban përshkrime të detajuara mbi procesin e regjistrimit të studentëve, strukturimin e planeve mësimore, organizimin e vitit akademik, zhvillimin e provimeve dhe procedurat për përgatitjen dhe shpërndarjen e diplomave. Gjithashtu, rregullorja specifike e programit të studimit "Infomatikë Biznesi" e hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015, përfshin edhe procedurat që lidhen me tërheqjen e diplomës. Departamenti i Menaxhimit ka përgatitur dhe zbatuar një sërë politikash dhe procedurash të strukturuar për orientimin dhe mbështetjen e studentëve, të cilat janë të formalizuara në dokumente udhëzuese specifike. Ndër to përfshihen Udhëzuesi i Praktikës, Udhëzuesi i Diplomës si dhe materiale të tjera që shërbejnë si burim reference gjatë gjithë procesit akademik.
	<i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i>

	<i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.6 UDHËZUES PRAKTIKE.pdf</i> <i>Aneksi 2.7 UDHËZUES - PUNIM DIPLOME.pdf</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Procesi i pranimit në programet e ciklit të parë të studimeve në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës bazohet në përcaktimet e Statutit të UNIKO-s dhe Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë. Ai zhvillohet në përputhje me kuotat dhe udhëzimet e miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit për vitin përkatës akademik. Pranimi u mundësohet shtetasve shqiptarë, shqiptarëve etnikë që banojnë jashtë kufijve shtetërorë si dhe shtetasve të huaj, të cilët plotësojnë kriteret përkatëse, pa asnjë diskriminim mbi bazën e gjinisë, moshës, origjinës apo përkatësisë etnike. Sipas Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë statusi i studentit fitohet pas regjistrimit pranë sekretarisë mësimore nga kandidatët e shpallur fitues. Ky proces realizohet përmes platformës digjitale Pitagora, e cila garanton transparencë, qasje të barabartë në informacion, shpërndarje në kohë reale dhe mbrojtje të konfidencialitetit të të dhënave personale. Zyra e Informimit dhe Orientimit të Studentëve ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke i informuar në mënyrë të paanshme për përdorimin e sistemit Pitagora, regjistrimin në platformë, ndjekjen e progresit akademik dhe të gjitha procedurat që lidhen me diplomimin, përfshirë edhe tërheqjen e diplomës. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e	Procesi i pranimit të studentëve në programin e studimit "Informatikë Biznesi" bazohet në një kuadër të gjerë ligjor dhe rregullator, i cili siguron transparencë dhe barazi në përzgjedhje. Ky proces mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë; në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli"; në Rregulloren e Universitetit si dhe në Rregulloret e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të



studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Menaxhimit. Angazhimi institucional për garantimin e standardeve të pranimit dhe vijimësisë akademike pasqyrohet qartë edhe në dokumente të tjera, si Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, e cila përfshin në mënyrë të detajuar dispozitat që lidhen me ruajtjen e integritetit akademik dhe masat ndaj shkeljeve përkatëse. Të gjitha dokumentet që përshkruajnë procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, progresin gjatë ciklit të studimeve, transferimin e krediteve dhe njohjen e studimeve të mëparshme, janë hartuar në formë të qartë dhe të kuptueshme për studentët dhe palët e interesuara. Këto materiale janë të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit, duke garantuar transparencë dhe akses të plotë për çdo individ të interesuar. <i>Referenca</i> Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT ‘FAN S. NOLI’.pdf Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDSHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Të gjitha aspektet që lidhen me pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin janë të rregulluara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar në aktet ligjore dhe nënligjore të Universitetit “Fan S. Noli” (UNIKO). Këto dokumente janë lehtësisht të aksesueshme për studentët dhe publikun e gjerë në faqen zyrtare të universitetit, në seksionin "Studentët / Informacioni i përgjithshëm ", duke garantuar transparencë dhe orientim të vazhdueshëm për të gjithë të interesuarit. Fakulteti i Ekonomisë ka vendosur një sistem të shumëkanalësh për informimin dhe orientimin e studentëve, i cili përfshin: • Dokumente fizike dhe digjitale: Rregullore, udhëzues, guida dhe fletëpalosje të shpërndara në Zyrën e Informimit të Studentëve dhe në sekretarinë mësimore; • Stenda informuese: Të vendosura në ambientet e fakultetit për publikimin e rregulloreve, orareve, planeve mësimore, njoftimeve administrative dhe kalendarëve të provimeve/diplomimeve; • Takime me studentët: Komunikim i drejtpërdrejtë për njoftimin mbi vendimet kryesore të marra nga organet drejtuese për ecurinë e studimeve;

	• Shërbime në sportel dhe online: Zyra e Informimit dhe sekretaria mësimore ofrojnë sqarime përmes komunikimit fizik dhe elektronik; • Përfshirja e stafit akademik: Drejtuesit e njësive bazë dhe pedagogët informojnë rregullisht studentët për kriteret akademike dhe mundësojnë orientim të vazhdueshëm për zhvillimin e karrierës së tyre universitare; <i>Referenca</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 2.13 KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, PËR PERZGJEDHJEN E KANDIDATËVE.pdf</i> <i>Aneksi 2.14 KRITERET PËR VLERËSIMIN DHE EKUIVALENTIMIN E DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR TRANSFERIM STUDIMESH DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI.pdf</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti i Korçës (UNIKO) publikon në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar informacione në faqen e tij zyrtare. Në këtë faqe gjenden të dhëna të rëndësishme mbi veprimtarinë akademike, strukturat dhe njësitë përbërëse të universitetit, programet e studimit, njoftime të ndryshme për studentët, materiale promovuese, si dhe informacion për kontaktet zyrtare. Kjo faqe synon të jetë një burim i hapur dhe i aksesueshëm për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu, përmes programit të transparencës, UNIKO siguron pasqyrimin e një game të gjerë informacioni mbi veprimtarinë akademike dhe administrative të institucionit, përfshirë marrëdhëniet me publikun dhe palët e interesit. Në web janë të publikuara gjithashtu kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për secilin program studimi, në mënyrë të qartë dhe të lehtë për t'u aksesuar nga studentët dhe individët e interesuar. <i>Referenca</i> https://unkorce.edu.al/ https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimet-2/
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe	Të gjitha programet e studimit në Universitetin e Korçës parashikojnë kuota të dedikuara për kandidatët që vijnë nga komuniteti rom dhe egjiptian, si dhe për personat në kushte të vështira sociale, duke synuar zgjerimin e mundësive për akses në arsimin e lartë. Në funksion të barazisë sociale, studentët jetimë (nga të paktën një prind) dhe studentët me aftësi të



shtresave të marginalizuara.	kufizuara përjashtohen nga pagesat e tarifave të shkollës. Kjo politikë synon të eliminojë barrierat ekonomike dhe të garantojë mundësi të barabarta për edukim dhe zhvillim personal e profesional për të gjithë. Përfshirja e këtyre studentëve mbështetet nga një klimë mirëkuptimi dhe ndjeshmërie brenda institucionit. Stafi akademik, në bashkëpunim me Këshillin e Studentëve, luan një rol aktiv në lehtësimin e integritit të tyre në jetën universitare. Ky angazhim pasqyron qasjen gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme të UNIKO-s ndaj edukimit si një e drejtë themelore për çdo individ. <i>Referenca</i> https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/UNIKO-Tabela-kuota-2024-2025-16.10.2024.pdf
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Para fillimit të çdo viti akademik, Universiteti i Korçës (UNIKO) harton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Këto kriteret përcaktohen në përputhje me Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019, duke siguruar trajtim të drejtë dhe mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët, si pjesë e angazhimit të UNIKO-s për gjithëpërfshirje dhe diversitet në arsimin e lartë. <i>Referenca</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimi-2/ https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/UNIKO-Tabela-kuota-2024-2025-16.10.2024.pdf
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Bazuar në RVB, në programet e studimit të ofruara nga njësitë bazë janë të parashikuara kuota të posaçme për kandidatët që vijnë nga shtresat sociale në nevojë, komuniteti i egjiptianëve dhe romëve dhe këta studentë përjashtohen nga pagesat e tarifave të shkollës, ndërsa stafi akademik angazhohet për të garantuar përfshirjen e tyre të plotë dhe të barabartë në procesin e studimeve. GVJ gjeti evidencë të kuotave të posaçme për komunitetin e egjiptianëve dhe romëve por jo evidencë për kuota të posaçme për kandidatët që vijnë nga shtresat sociale në nevojë. Bazuar në RVB, studentët kanë mundësi të përfitojnë bursa studimi nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në legjislacionin



	në fuqi dhe UNIKO administron edhe shpërblime të veçanta për studentët, të cilat miratohen nga Bordi i Administrimit, duke ofruar kështu një mbështetje të mëtejshme për përparimin e tyre akademik dhe social. <i>Referenca</i> FINAL RVB. BA IB LINK.pdf https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/UNIKO-Tabela-kuota-2024-2025-16.10.2024.pdf			
Konkluzione	GVJ konstaton se të gjitha aspektet që lidhen me pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin janë të rregulluara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar në aktet ligjore dhe nënligjore të Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit të paraqitur nga UNIKO pranë ASCAL-it, si dhe nga takimet me studentët dhe stafin akademik gjatë vizitës në institucion, rezulton se studentët e këtij programi gëzojnë akses të plotë në informacionin që lidhet me ecurinë dhe përparimin e tyre akademik. Ky informacion u vihet në dispozicion në mënyrë të vazhdueshme përmes disa kanaleve komunikimi, ku një ndër burimet më të rëndësishme është faqja zyrtare e internetit e UNIKO-s, e cila ofron të dhëna të përgjithshme, të përditësuara dhe të lehtësisht të aksesueshme për studentët. <i>Referenca</i> Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI".pdf Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf



	<i>Anksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDASHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>https://unkorce.edu.al/</i> <i>Vizita e GVJ në UNIKO</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UNIKO dhe Fakulteti Ekonomik u bëjnë të ditur studentëve, në përputhje me rregulloret përkatëse, kriteret që lidhen me njohjen e studimeve të mëparshme. Ky proces përfshin vlerësimin e llojit të institucionit arsimor ku janë kryer studimet, si dhe nëse ato janë përfunduar në mënyrë të plotë apo të pjesshme. Institucioni pranon kërkesa për transferim studimesh nga programe, fakultete apo universitete të tjera, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Transferimet miratohen nëse përmbushen kërkesat për kredite, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UNIKO-s. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDASHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi", së bashku me Rregulloren e Fakultetit Ekonomik, përmbajnë dispozita të qarta dhe të strukturuar mbi mënyrat e vlerësimit të njohurive akademike. Këto rregullore përshkruajnë në detaje format e vlerësimit, duke përfshirë provimet e pjesshme dhe përfundimtare për secilën lëndë, si dhe mënyrën e organizimit dhe hartimit të tezave. Përveç kësaj, janë përcaktuar qartë procedurat që lidhen me miratimin e tezave, duke mbuluar si aspektin administrativ ashtu edhe atë akademik. Të gjitha këto elemente sigurojnë një proces vlerësimi transparent, të strukturuar dhe në përputhje me standardet institucionale dhe ligjore. <i>Referenca</i> <i>Anksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>

	<i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BREND SHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BREND SHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e Brendshme e Fakultetit Ekonomik së bashku me Rregulloren e programit të studimit “Informatikë Biznesi”), përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha hapat që studentët duhet të ndjekin gjatë procesit të diplomimit, duke filluar nga përzgjedhja e temës, përgatitja e punimit dhe deri në mbrojtjen përfundimtare. <i>Referenca</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BREND SHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BREND SHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Informacioni për studentët u ofrohet përmes një sërë kanalesh komunikimi, në përputhje me sa parashikohet në Rregulloren e njësive kryesore (Kreu XV, Neni 114). Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” shërben si një dokument orientues dhe udhëzues, duke ndihmuar studentët e ardhshëm dhe të interesuarit të njihen me përmbajtjen dhe strukturën e programit. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila harton materiale informuese si fletëpalosje dhe organizon takime prezantuese për studentët potencialë. Veprimtaria e QKA për çdo vit akademik përmbledhet në mënyrë të strukturuar në dokumentin e Analizës së Veprimtarisë. <i>Referenca</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BREND SHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Anksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se UNIKO ka në dispozicion një dokumentacion të plotë, të mirëstrukturuar dhe në përputhje me aktet rregullatore, i cili garanton informimin e studentëve në çdo fazë të procesit akademik. Ky dokumentacion përmban qartësisht kriteret e pranimit në programin e studimit, detyrimet e studentëve gjatë ndjekjes së programit, rregullat

	dhe afatet për përmbushjen e këtyre detyrimeve, si dhe udhëzimet e hollësishme për përzgjedhjen dhe hartimin e temës së diplomës dhe zhvillimin e procesit të diplomimit. Gjithashtu, në këtë kuadër janë të përcaktuara në mënyrë transparente edhe kriteret për pranimin dhe transferimin e studimeve, duke mundësuar orientim të saktë për studentët dhe respektim të standardeve akademike në çdo hap të formimit të tyre universitar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, e shoqëruar me shtojcat përkatëse, përmban informacion të plotë dhe të strukturuar mbi objektivat formuese, organizimin, strukturën dhe përmbajtjen akademike të programit. Ajo gjithashtu përshkruan në mënyrë të qartë rezultatet e pritshme të të nxënit dhe ofron një pasqyrë të mundësive të punësimit për studentët pas përfundimit të studimeve, duke e bërë këtë dokument një mjet orientues të rëndësishëm për studentët aktualë dhe të ardhshëm. <i>Referenca</i> Anksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, së bashku me Kurrikulën përkatëse, ofron informacion të detajuar dhe të dobishëm për studentët, duke përfshirë programin mësimor të strukturuar sipas lëndëve dhe moduleve. Ky dokument përcakton qartë ngarkesën mësimore, si brenda auditorit ashtu edhe jashtë tij. Gjithashtu, studentët informohen që në fillim të procesit mësimor për përmbajtjen e secilës lëndë, çka u mundëson atyre orientim të qartë dhe përgatitje të mirëfilltë gjatë ndjekjes së programit.



	<i>Referenca</i> <i>Anksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.1 KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UNIKO ka integruar në strukturën e vet organizative Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e studentëve për sa i përket orientimit profesional dhe mundësive të punësimit. Kjo qendër ofron trajnime dhe këshillim, duke i ndihmuar studentët të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për integrimin e tyre profesional. Aktivitetet e QKA mbështeten në analizën e të dhënave të disponueshme dhe zhvillohen në përputhje me Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, Kreu III, Neni 9, pikat 6, 7 dhe 10. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.5 RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DKVI.pdf</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në fillim të çdo viti akademik ose semestri, Fakulteti i Ekonomisë, në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit, përgatit dhe publikon dokumentacionin përkatës që u shërben studentëve për orientim të qartë në procesin mësimor. Ky dokumentacion përfshin: 1. Strukturën mësimore të programit të studimit; 2. Orarin e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë, Kreu IX, Neni 69; <i>Referenca</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i	Informacioni lidhur me programin e studimit u vihet në dispozicion studentëve përmes një sërë kanalesh komunikimi, në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Menaxhimit. Një ndër mjetet kryesore për shpërndarjen e këtij informacioni është sistemi elektronik i menaxhimit të informacionit PITAGORA, i cili është i shpjeguar në mënyrë të detajuar në manualin përkatës, faqet 18–19.

arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Përveç platformës PITAGORA, informacioni është gjithashtu i aksesueshëm përmes strukturave institucionale si Sekretaria Mësimore, Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), si dhe përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me stafin akademik. Kjo shumëllojshmëri kanalesh siguron informim të plotë dhe të vazhdueshëm për studentët. <i>Reference</i> <i>Shtojca 1.6.1 MANUAL I SISTEMIT ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UNIKO siguron për studentët informacion të qartë, të plotë dhe të detajuar mbi të gjitha aspektet thelbësore të programit të studimit. Ky informacion përfshin objektivat formues, strukturën dhe organizimin e programit, përmbajtjen akademike, rezultatet e pritshme të të nxënit, si dhe perspektivat e punësimit pas përfundimit të studimeve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në UNIKO u konstatua se sekretaria mësimore e Departamentit të Menaxhimit disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve, numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit ose mospërfundimin me sukses të vitit akademik gjatë të cilit zhvillohet programi i studimit.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit	Gjatë vizitës u konstatua se të dhënat e cituara më sipër ruhen në formë të shkruar (hard copy) sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 71 të statutit të UNIKO-së, i cili detyrohet të mbajë të dhënat në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë":

apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	a) Regjistri themeltar i studentëve të UNIKO-së, i cili është i plotësuar gjithashtu në formë elektronike (Sipas Statutit të UNIKO, Kreu VIII, Neni 82, 83); b) Regjistri i arritjeve akademike për çdo student të regjistruar në UNIKO për këtë program studimi, gjithashtu i plotësuar në formë elektronike; c) Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, gjithashtu i plotësuar në formë elektronike, në përputhje me kërkesat e Rregullores së këtij sektori të UNIKO-së, Nenet 5-14; Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në tre vite akademike është si më poshtë vijon: <table border="1" data-bbox="609 701 1316 969"> <tr> <th colspan="2">Programi i Studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi"</th></tr> <tr> <th>Viti</th><th>Studentë të Regjistruar</th></tr> <tr> <td>2024-2025</td><td>19</td></tr> <tr> <td>2023-2024</td><td>9</td></tr> <tr> <td>2022-2023</td><td>19</td></tr> </table> <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.10 RREGULLORE E SEKTORIT TE STUDIMEVE DHE SEKTORIT TE TIK.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>	Programi i Studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi"		Viti	Studentë të Regjistruar	2024-2025	19	2023-2024	9	2022-2023	19
Programi i Studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi"											
Viti	Studentë të Regjistruar										
2024-2025	19										
2023-2024	9										
2022-2023	19										
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Rregullorja e Brendshme e Fakultetit të Ekonomisë, në Kreun XV, Neni 113, nënvizon rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale të studentëve, duke garantuar ruajtjen dhe trajtimin e tyre me kujdes dhe përputhje me kuadrin ligjor. Këto standarde janë të përcaktuara edhe në Statutin e UNIKO-s, Kreu VIII, Neni 83. Në këtë kuadër, sistemi elektronik PITAGORA, i implementuar në bashkëpunim me RASH, luan një rol kyç në administrimin e të dhënave studentore që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>										



	<i>Shtojca 1.10 RREGULLORE E SEKTORIT TE STUDIMEVE DHE SEKTORIT TE TIK.pdf</i> <i>Shtojca 1.6 MARRËVESHJA ME RASH PËR SISTEMIN ELEKTRONIK PITAGORA.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në statutin e UNIKO dhe Rregulloren e Sektorit të Studimeve dhe të Sektorit të TIK UNIKO garanton mbështetje institucionale për menaxhimin e të dhënave studentore përmes akteve përkatëse dhe kryen kontrole të rregullta mbi njësitë përgjegjëse, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe saktësisë së informacionit. Vlerësimi dhe dokumentimi i të dhënave që lidhen me studentët dhe aktivitetet e tyre realizohet në mënyrë sistematike, në përputhje me parashikimet e Rregullores së Sektorit të Studimeve dhe të Sektorit të TIK, Kreu II, nenet 10, 11 dhe 12. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.10 RREGULLORE E SEKTORIT TE STUDIMEVE DHE SEKTORIT TE TIK.pdf</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në dokumentin “Aneksi 2.21 – Raportet Vjetore të Veprimtarisë së Departamentit të Menaxhimit”, konstatohet se Departamenti harton raporte analitike dhe periodike mbi profilin e studentëve, cilësinë në hyrje dhe dalje, si dhe mbi shkallën e punësimit pas diplomimit. Megjithatë, GVJ vëren një mospërputhje të të dhënave midis këtij dokumenti dhe “Aneksit 5.1 – Të Dhëna Statistike për Studentët e Programit të Studimit ‘Informatikë Biznesi’ për Tre Vitet e Fundit”, si dhe ndërmjet këtij dokumenti dhe tabelave përkatëse në dokumentin “Tabelat përmbledhëse për aneks”. Për këtë arsye, <u>GVJ sugjeron që të dhënat statistikore për studentët e këtij programi të përditësohen dhe harmonizohen, me qëllim garantimin e saktësisë dhe koherencës në raportim.</u> <i>Referenca</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 5.1 TË DHËNA STATISTIKORE PËR STUDENTËT E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI PËR TRE VITET E FUNDIT.pdf</i> <i>TABELAT PËRMBLEDHËSE PËR ANEKS.pdf</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se UNIKO administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve të programit të studimit, që nga pranimi deri në

	<i>diplomim, përfshirë edhe të dhëna mbi punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve. Departamenti i Menaxhimit harton raporte analitike dhe periodike mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe mbi nivelin e punësimit të tyre.</i> <i>GVJ rekomandon që të dhënat statistikore për studentët e këtij programi të përditësohen rregullisht dhe të harmonizohen midis dokumenteve përkatëse, me qëllim garantimin e saktësisë dhe koherencës së informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UNIKO, në përputhje me nenet 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, si dhe me nenin 79 të Statutit të institucionit, garanton të drejtën e studentëve për përfaqësim në organet vendimmarrëse. Studentët kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen si përfaqësues në Senatin Akademik, ku përfaqësimi i tyre është 10%, si edhe në komisionet përkatëse të institucionit. Bazuar në dispozitat e Statutit të UNIKO-s (Kreu VIII, Neni 79, pika 2), kjo e drejtë zbatohet në mënyrë të strukturuar në të gjitha nivelet. Studentët mund të organizohen në këshilla studentorë si në nivel njësie bazë, ashtu edhe në nivel institucional dhe kombëtar, sipas përcaktimeve në nenin 80 të Statutit (pika 1) dhe në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë (Kreu XIV, Neni 107, pika b). Kjo pjesëmarrje aktive forcon rolin e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe rrit transparencën institucionale. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT ‘FAN S. NOLI’.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UNIKO garanton përfshirjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse, këshilluese dhe vlerësuese përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik me 10% të anëtarëve, në Këshillin e Etikës, NJSBC, si dhe në Komisionin Institucional dhe atë të Fakultetit për Zgjedhjet. Procesi i përzgjedhjes së përfaqësuesve realizohet në mënyrë transparente dhe garanton barazi në pjesëmarrje. Studentët organizohen në Këshilla Studentore në nivel fakulteti dhe institucioni, sipas Rregullores përkatëse (Aneksi I.17). Në Fakultetin e Ekonomisë, çdo grup mësimor zgjedh dy senatorë për të përfaqësuar interesat e tyre në Këshillin Studentor të fakultetit, i cili promovon dhe koordinon pjesëmarrjen e studentëve në organet drejtuese dhe strukturat e tjera institucionale. Këshilli Studentor ka të drejtë të shprehë mendime dhe propozime për çështje me interes të përgjithshëm si planet dhe programet e studimit, rregulloret akademike, cilësinë e shërbimeve, si dhe organizimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive, duke kontribuar në jetën aktive universitare dhe zhvillimin institucional. <i>Referenca</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.17 RREGULLORJA E KËSHILLIT STUDENTOR.pdf</i> <i>Shtojca 1.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në UNIKO</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	UNIKO siguron përfshirjen aktive të studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, duke u mbështetur në opinionet dhe sugjerimet e tyre. Kjo praktikë bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe në Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI), përmes së cilës NJSBC organizon në fund të çdo semestri pyetësorin studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Rezultatet dhe komentet e mbledhura përfshihen në raportet vlerësuese të NJSBC. Në Fakultetin e Ekonomisë, rishikimi periodik i programit të studimit zhvillohet në fund të çdo viti akademik, duke u bazuar edhe në mendimet dhe sugjerimet e studentëve. Këto opinione mbledhen përmes pyetësorëve të organizuar nga fakulteti në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, për çdo modul mësimor, siç përcaktohet në Rregulloren e Brendshme të FE (Kreu XIII, Neni 105, pika 2). Gjithashtu, Këshilli Studentor i Fakultetit luan një rol aktiv në përcimin e

	mendimeve dhe propozimeve të studentëve në organet drejtuese të fakultetit, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe mjedisit të të nxënit. Statuti i Universitetit të Korçës përcakton se Këshillat Studentore kanë për detyrë të promovojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese, si dhe të shprehin opinione dhe japin propozime mbi çështje me rëndësi institucionale, përfshirë programet e studimit, cilësinë e shërbimeve dhe shpërndarjen e burimeve financiare. Gjithashtu, në kuadër të sigurimit të cilësisë së brendshme, pranë Sektorit të Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni funksionon Njësia e Sigurimit të Cilësisë, ku përfshihet edhe një përfaqësues studentor. Kjo njësi është ngritur në nivel fakulteti dhe në çdo njësi akademike, duke garantuar përfaqësimin e studentëve në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.5 RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DKVI.pdf</i> <i>Aneksi 3.1 MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE.pdf</i> <i>Shtojca 1.17 RREGULLORJA E KËSHILLIT STUDENTOR.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët në UNIKO kanë të drejtën të japin feedback mbi drejtësinë dhe cilësinë e procesit mësimor përmes pyetësorëve të organizuar në fund të çdo semestri, proces i cili menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ku përfaqësohen edhe vetë studentët. Kjo përfaqësim siguron që opinionet e tyre të merren në konsideratë gjatë analizës së performancës akademike dhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përveç vlerësimeve akademike, studentët kanë të drejtë të shprehen edhe për çështje të tjera si etika në komunikim, ankimet për rezultate dhe reagimi institucional ndaj shqetësimeve të tyre. Këto të drejta janë të garantuara në Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Ekonomisë, ndërsa Fakulteti dhe Departamenti i Menaxhimit sigurojnë një proces transparent për kontrollin dhe vlerësimin e dijeve, duke përfshirë informimin mbi procedurat, vlerësimin e vazhduar,

	zhvillimin e provimeve dhe publikimin e rezultateve përfundimtare. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UNIKO përfshin studentët në mënyrë aktive në vlerësimin e procesit akademik, duke u mbështetur në të dhëna të strukturuar dhe të matshme të mbledhura përmes pyetësorëve të përgatitur dhe administruar nga NJBSC.</i> <i>Këto instrumente përdoren për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë dhe program studimi, përfshirë edhe programin Bachelor në "Informatikë Biznesi", duke reflektuar angazhimin e institucionit për përmirësim të vazhdueshëm akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në Rregulloren e Brendshme të FE (Kreu XV, Neni 114 – Aneksi I.28) përcaktohet një sistem i mirëorganizuar për informimin dhe orientimin e studentëve në Universitetin e Korçës (UNIKO) dhe në Fakultetin e Ekonomisë (FE). Ky sistem siguron komunikimin e informacionit mbi programet e studimit, procesin mësimor, rregulloret dhe procedurat administrative, si dhe vendimet e strukturave drejtuese që prekin studentët. Informacioni shpërndahet përmes kanaleve të ndryshme si faqja zyrtare e UNIKO-s, takime të drejtpërdrejta, platforma online, rrjete sociale (Facebook), fletëpalosje, stenda informuese dhe video në monitorët e fakultetit. Një rol të veçantë në këtë proces luan edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), e cila në bashkëpunim me njësitë bazë, angazhohet në promovimin e programeve dhe orientimin e studentëve të rinj.

	<i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) në UNIKO luan një rol të rëndësishëm në kuadër të informimit dhe ofrimit të shërbimeve për studentët, QKA mbështet studentët si gjatë kohës së studimeve, ashtu edhe pas përfundimit të tyre. QKA synon të ruajë një kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe të diplomuarit, duke u shërbyer si urë lidhëse midis tyre dhe mundësive akademike apo profesionale. Veprimtaria e QKA përfshin ofrimin e informacionit të detajuar mbi programet e studimit, mundësitë për orientim profesional dhe karrierë, si dhe këshillim individual apo në grup. Kjo qasje shumëdrejtimeshe synon të ndihmojë studentët në marrjen e vendimeve të informuara për rrugën e tyre akademike dhe profesionale. Në shërbim të nevojave të studentëve është edhe Zyra e Informimit dhe Orientimit të Studentit në UNIKO, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë ciklit të studimeve. Ajo luan një rol kyç në orientimin e studentëve të rinj, duke i këshilluar dhe asistuar për kërkesat e programeve të studimit, ndjekjen e progresit akademik dhe dhënien e përgjigjeve për pyetjet apo nevojat që ata kanë. Përveç kësaj zyre, edhe sekretaria mësimore, autoritetet drejtuese dhe stafi akademik kontribuojnë në informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve në Fakultetin e Ekonomisë, duke garantuar një proces të qartë komunikimi dhe orientimi akademik. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i> https://unkorce.edu.al/stafi-administrativ-3/
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe	Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) në UNIKO, e integruar në Sektorin e Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA), ka për mision mbështetjen e studentëve në përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe zhvillimin e aftësive për integrim të suksesshëm në tregun e punës. Gjatë gjithë vitit akademik, QKA organizon aktivitete informuese dhe promovuese që nisin që nga faza e orientimit paraprak për




periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	maturantët, prezantimi i programeve të studimit dhe vazhdojnë me këshillim të studentëve të vitit të parë mbi të drejtat, detyrimet, sistemin e krediteve dhe procedurat akademike. Qendra ofron gjithashtu mbështetje për realizimin e detyrave, temave të diplomës dhe aplikimet për mobilitete, bursa apo veprimtari jashtë vendit. Në aspektin profesional, QKA luan një rol aktiv në ndërmjetësimin mes studentëve dhe punëdhënësve, duke përfaqësuar UNIKO në panaire pune, duke lehtësuar organizimin e praktikave dhe intershipeve, si dhe duke zhvilluar trajnime dhe këshillime që ndihmojnë studentët të identifikojnë interesat dhe aftësitë e tyre, të njohin tregun e punës dhe të përgatiten për procesin e aplikimit, përfshirë përgatitjen e CV-së, letrës së motivimit dhe intervistës. Të gjitha aktivitetet realizohen në bashkëpunim me njësitë bazë dhe përshtaten sipas fushës dhe nivelit të studimit. <i>Referenca:</i> https://unkorce.edu.al/sektori-i-kurrikules-vleresimit-institucional-dhe-alumni/ https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/PLANI-VJETOR-SEKTORI-I-KURRIKULAVE-2023-2024.pdf <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) në UNIKO ka si funksion kryesor mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave mbi nivelin dhe cilësinë e punësimit të studentëve, funksion që plotësohet edhe nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë pranë Fakultetit të Ekonomisë, e cila ndjek ecurinë e punësimit dhe vlerëson efektivitetin e programeve të studimit. QKA menaxhon Rrjetin Alumni, duke mbajtur kontakte të rregullta me të diplomuarit dhe punëdhënësit potencialë, për të promovuar studentët dhe për të identifikuar mundësi të reja punësimi. Ajo përditëson vazhdimisht një bazë të dhënash mbi punësimin e studentëve, ndërsa përmes faqes zyrtare të UNIKO-s publikon informacione mbi studentët e ekselencës, si pjesë e promovimit të kapaciteteve të universitetit. Përmes përfshirjes së studentëve të diplomuar në aktivitetet e saj, QKA forcon bashkëpunimin me studentët aktualë, duke nxitur shkëmbimin e ideve, eksperiencave dhe zhvillimin e rrjeteve që ndihmojnë përballjen me tregun e punës. Vihet re se analiza e veprimtarisë së qendrës së karrierës dhe alumnit është e viti 2022 -2023 dhe të dhënat në website janë të Gjatë vizitës në institucion u

	theksua se, për të përmbushur më mirë detyrat dhe funksionet e saj, planifikohet shtimi i një specialisti të ri në QKA. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 2.22 ANALIZA E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT.pdf</i> https://unkorce.edu.al/qka-statistika-2/ <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UNIKO, nëpërmjet një sistemi të mirëorganizuar të përcaktuar në Rregulloret përkatëse dhe të zbatuar në FE, siguron informimin e studentëve përmes kanaleve të ndryshme dhe mbështetjes së QKA.</i> <i>Institucioni garanton këshillim dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve përmes QKA-së, Zyrës së Informimit dhe strukturave të tjera akademike. QKA ofron shërbim të strukturuar për këshillim karriere, duke përfshirë orientim profesional, ndihmë për praktika dhe intershipte, si dhe përgatitje për tregun e punës.</i> <i>QKA ndjek punësimin e studentëve pas diplomimit, menaxhon Rrjetin Alumni dhe përditëson të dhënat për punësim, ndërsa planifikohet shtimi i një specialisti për forcimin e mëtejshëm të funksioneve të saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Akris

[Signature]

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi në UNIKO ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë në mësimdhënie në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë. Institucioni ka hartuar udhëzues institucional për zhvillimin e metodave të ndryshme e inovative të mësimdhënies, të përshtatura me fushën e studimit dhe veçoritë e lëndëve. Manuali i cilësisë së UNIKO përcakton qartë strukturat, procedurat dhe përgjegjësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ndërsa kultura e cilësisë promovohet përmes bashkëpunimit të stafit dhe studentëve. Nga takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët për lëndët e profilit në këtë program, seminarët zhvillohen edhe në mjedise laboratorike, duke garantuar aplikimin e praktikave moderne dhe interaktive në përputhje me objektivat e zhvillimit të fakultetit dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në programin Bachelor në Informatikë Biznesi pranë UNIKO, parimet dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë të mirëstrukturuara dhe të bazuara në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, i miratuar nga Senati Akademik me vendim zyrtar. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) monitoron në mënyrë të vazhdueshme mekanizmat dhe planifikimin që nevojitet për realizimin e vetëvlerësimit. NJSBC, në bashkëpunim me Komisionin për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Studimit pranë Fakultetit Ekonomik, programi garanton përputhshmëri me standardet akademike kombëtare dhe evropiane. Këto struktura vlerësojnë rregullisht cilësinë e mësimdhënies, planifikimin kurrikular dhe rezultatet e të nxënit, duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes raporteve vjetore dhe politikave të përcaktuara në Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit.



	<i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni garanton përfshirjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies, si dhe të metodave të vlerësimit të dijeve, përmes mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të sigurimit të cilësisë. Studentët përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes pyetësorëve të fund-kursit dhe sondazheve të organizuara nga SKVIA dhe ASCAL, siç është Sondazhi Kombëtar i Studentëve (SKS). Vlerësimet e mbledhura shërbejnë si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programin Bachelor në Informatikë Biznesi. Megjithatë, edhe pse ekzistojnë struktura funksionale si NJSBC dhe mekanizma si GVB që realizojnë vlerësim vjetor të brendshëm, nuk janë gjetur prova të qarta për masa konkrete të marra në rastet kur janë identifikuar mospërputhje me standardet, apo për mënyrën e adresimit të rekomandimeve të dhëna nga ASCAL dhe KLSH. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 3.1 MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE MODEL I PYETËSORIT STUDENTOR I ORGANIZUAR NGA FE.pdf</i> <i>Takimi në institucion me stafin akademik dhe studentet</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në UNIKO, strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie monitorojnë dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret institucionale. Komisionet e vlerësimit, të përbëra nga jo më pak se dy anëtarë, përfshirë titullarin e lëndës, zhvillojnë procesin e vlerësimit përfundimtar në bazë të përmbajtjes së syllabusit dhe akteve në fuqi. Gjithashtu, NJSBC-ja harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm për cilësinë e programeve të studimit dhe publikon të dhënat përkatëse në faqen zyrtare të UNIKO, duke siguruar transparencë dhe përfshirje të të gjitha palëve të interesuara në proceset akademike. Këto të dhëna mbështeten edhe nga analizat vjetore të Fakultetit Ekonomik dhe pyetësorët

	studentorë të zhvilluar në fund të kurseve. Ato mund të gjenden në faqen e internetit në të përmbledhura në rang universiteti. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i> https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Relacioni-permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet në institucion me drejtuesit dhe stafin akademik në UNIKO personeli akademik nxitete dhe mbështetet në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Vlerësimet periodike të personelit akademik analizohen në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore dhe bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e departamentit, ku promovohen praktikat efektive të mësimdhënies dhe nxiten përpjekjet për zhvillim profesional. Fakulteti Ekonomik ndërgjegjëson dhe informon rregullisht stafin akademik, administrativ dhe studentët mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, përmes takimeve të asamblesë dhe aktiviteteve të tjera institucionale. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet pedagogëve të departamentit, studentëve dhe përfaqësuesve të NJSBC-së përforcon më tej përkushtimin ndaj cilësisë në procesin mësimor. <i>Referenca:</i> <i>RVB BA IB.pdf</i> <i>Takimet në institucion me dekanenën, përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik</i>			
Konkluzione	GVJ kostaton se UNIKO, në programin "Bachelor në Informatikë Biznesi", ka ndërtuar dhe zbatuar një qasje të strukturuar dhe funksionale në drejtim të përmirësimit të cilësisë akademike. Vlerësimi dhe promovimi i praktikave të mira nëpërmjet analizave periodike dhe nxitjes së përmirësimit të vazhdueshëm të stafit akademik dëshmojnë për një angazhim të qëndrueshëm ndaj cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VL2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore institucionale, Universiteti "Fan S. Noli" ka ndërtuar një sistem të qartë dhe funksional për sigurimin e brendshëm të cilësisë, i cili përfshin politika, struktura dhe procedura të përcaktuara mirë. Përgjegjësia për sigurimin e cilësisë ndahet midis Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), që operon në nivel institucional dhe monitoron të gjithë programet e studimit, dhe Departamenteve përkatëse të Fakulteteve (DFK), të cilat kujdesen për përmirësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të programeve mësimore. Politikat e sigurimit të cilësisë janë të dokumentuara në Statutin e universitetit, në rregulloret dhe manualët e cilësisë, si dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit, dhe janë në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe standardet europiane për arsimin e lartë. Përmes vlerësimeve të rregullta, monitorimit institucional dhe përfshirjes aktive të aktorëve të brendshëm, institucioni siguron zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe administrative. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Universiteti "Fan S. Noli" ka ngritur dhe funksionalizon në mënyrë të qëndrueshme Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në përputhje me kërkesat ligjore dhe strategjinë e zhvillimit 2022-2027. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) operon në nivel institucional dhe mbështetet nga politika të qarta institucionale, struktura funksionale dhe dokumente rregullative si Manuali i Cilësisë dhe Rregullorja e DKVI. NJSBC përfshin përfaqësues nga njësitë kryesore, organizatat studentore dhe ekspertë të jashtëm, duke siguruar përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve në procesin e përmirësimit të cilësisë. Në nivel fakulteti, funksionojnë gjithashtu njësi të ngjashme që ndjekin të njëjtat parime. Veprimtaria e këtyre strukturave është e dokumentuar dhe e publikuar në mënyrë transparente në faqen zyrtare të universitetit, ndërsa në rastet e akreditimit, krijohen grupe të posaçme të vlerësimit të brendshëm (GVB),




	duke reflektuar angazhim të vazhdueshëm për cilësi të lartë dhe përmirësim institucional. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i> <i>Takimet në institucion me zyrën e NJSBC dhe organet drejtuese</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UNIKO përdor një gamë të gjerë instrumentesh dhe treguesish të përshtatshëm për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, duke përfshirë organizimin dhe menaxhimin e njësive akademike dhe administrative, planifikimin financiar të qëndrueshëm, politikat e rekrutimit të stafit, zhvillimin e kurrikulës, metodat interaktive të mësimdhënies, promovimin e kërkimit shkencor, si dhe rritjen e mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve. Ky sistem është i përshkruar dhe i rregulluar në Manualin e Cilësisë së UNIKO-së, i cili garanton përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe standardet e arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe evropian. Përveç kësaj, sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të akreditimit institucional dhe programor, si dhe përmes vlerësimeve të jashtme analitike dhe krahasuese, ku një rol të rëndësishëm ka edhe Sondazhi Kombëtar i Studentëve (SKS) i organizuar nga ASCAL. Këto mekanizma sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe programeve të studimit, duke garantuar transparencë dhe përfshirje aktive të të gjitha palëve të interesuara. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën	Në UNIKO në fund të çdo viti akademik, njësitë bazë realizojnë vlerësime të performancës së stafit akademik dhe të veprimtarisë kërkimore, të cilat përfshihen në Raportet Vjetore të Fakultetit dhe Institucionit. Përveç kësaj, institucioni organizon pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në fund të semestrit dhe para provimeve, ndërsa Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti monitoron vazhdimisht efektivitetin e programeve dhe proceset akademike, duke hartuar raporte për përmirësimin e vazhdueshëm.

promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Referenca: Shtojca 1.16 Manuali i Cilësive të UNIKO.pdf https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Relacioni-permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UNIKO ka ngritur një sistem të mirëorganizuar të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke përfshirë politika, struktura dhe procedura të qarta, në përputhje me legjislacionin dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare. Institucioni përdor instrumente dhe tregues të matshëm për monitorimin dhe vlerësimin e performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe përfshin studentët në proceset e vlerësimit. Rezultatet e këtyre vlerësimeve publikohen në mënyrë transparente dhe përdoren për promovimin e praktikave të mira dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe analizën përkatëse, GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë UNIKO ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ngritjen dhe funksionalizimin e strukturave dhe mekanizmave për hartimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, përfshirë programin Bachelor në "Informatikë Biznesi", i cili i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit. Edhe pse programi është në fazat e para të zbatimit, janë evidentuar përpjekje për përfshirjen e palëve të interesuara, përdorimin e analizave institucionale dhe të tregut të punës, si dhe aplikimin e procedurave standarde për sigurimin e cilësisë. <u>Rekomandohet forcimi i mëtejshëm i dokumentimit dhe raportimit specifik për këtë program në raportet e vlerësimit të brendshëm dhe planifikimi i rishikimeve periodike bazuar në të dhënat empirike të performancës së programit.</u>




Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<i>Referenca:</i> <i>Aneksi 2.10 RREGULLORE E BRENDASHME E DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.11 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFORMATIKË BIZNESI.pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.17 STUDIMET E TREGUT.pdf</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në UNIKO janë kryer raporte të cilat përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe veprimtarisë kërkimore, të shoqëruara me të dhëna sasiore, vlerësim sipas standardeve, dhe analizë SWOT. Raportet përmbajnë elementë përshkrues dhe tregues matës, të cilët dokumentojnë arritjet dhe identifikojnë fushat që kërkojnë përmirësim. Për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është kryer vetëvlerësim në nivel fakulteti dhe departamenti, duke përfshirë analiza të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore. Raportet përmbajnë përshkrime cilësore, tregues të matshëm dhe vlerësime sipas standardeve, të shoqëruara me analizë SWOT. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>Aneksi 2.17 STUDIMET E TREGUT.pdf</i> https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Relacioni-permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së	Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhimit në UNIKO kanë vendosur një sistem të mirëorganizuar të monitorimit dhe raportimit të cilësisë së programit të studimit përmes raporteve vjetore të veprimtarisë, të cilat përfshijnë objektivat, rezultatet e arritura, analizat përshkruese dhe krahasuese, si dhe masat e rekomanduara për përmirësim. Këto raporte ruhen në arkivën institucionale dhe janë të aksesueshme në faqen zyrtare të universitetit. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në nivel institucioni dhe njësie kryesore, informon përkatësisht Senatin Akademik dhe Dekanatin mbi rezultatet dhe rekomandimet për përmirësim. Pedagogët kontribuojnë gjithashtu përmes relacioneve për çdo lëndë dhe pyetësorëve me studentët, duke

ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	nd ihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Relacioni-permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Duke u bazuar ne RVB dhe nga takimet në institucion për programin Bachelor në Informatikë Biznesi në UNIKO, institucioni përdor metoda dhe instrumente të tërthorta për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit, si: • Organizohen sondazhe dhe intervista me studentët aktualë për të mbledhur opinionet e tyre mbi mësimdhënien, kurrikulën dhe shërbimet e ofruara; • Realizohen sondazhe me studentët e diplomuar (alumni) për të vlerësuar ndikimin e programit në karrierën e tyre dhe për të marrë sugjerime për përmirësim; • Përdoren pyetësorë dhe intervista me personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, për të vlerësuar proceset dhe bashkëpunimin në zhvillimin e programit; <i><u>RVI rekomandon përmirësimin e mekanizmat për mbledhjen sistematike të të dhënave nga alumni dhe punëdhënësit, si dhe të përdorë këto të dhëna aktivisht për planifikimin dhe zhvillimin strategjik të programit.</u></i> <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Relacioni-permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf</i>
Konkluzione	<i>UNIKO ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin sistematik të programit Bachelor në Informatikë Biznesi, duke përdorur struktura dhe mekanizma të përshtatshëm për sigurimin e cilësisë.</i>




	<i>Rekomandohet thellimi i dokumentacionit dhe raportimit të performancës, si dhe përdorimi më aktiv i feedback-ut nga alumnit dhe punëdhënësit për zhvillimin strategjik të programit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe përshtatjen me nevojat aktuale të tregut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në dokumentacionin, konstatohet se UNIKO ka krijuar dhe zbatuar politika dhe procedura të brendshme të sigurimit të cilësisë që përfshijnë në mënyrë të plotë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuar. Kjo përfshirje e gjerë siguron një proces gjithëpërfshirës për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke u mbështetur në manuale dhe plane strategjike të detajuara që përcaktojnë organizimin dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse. Kjo qasje përbën një bazë të fortë për zhvillimin dhe monitorimin efektiv të programeve, duke garantuar transparencë dhe bashkëpunim ndërmjet njësive akademike, stafit dhe studentëve. <i>Referencat:</i> <i>Shtojca 1.3 PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Bazuar në informacionin e paraqitur në dokumentacionin mbështetës dhe gjetjet gjatë vizitës, rezulton se institucioni ka përcaktuar në mënyrë të qartë përgjegjësi dhe detyra për njësitë strukturore, individët dhe palët e interesuara, përfshirë studentët, në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Proceset e analizës periodike në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përfshihen diskutime të hapura dhe pjesëmarrje aktive e

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	aktorëve të brendshëm, dëshmojnë për një angazhim të strukturuar dhe të përgjegjshëm ndaj përmirësimit të cilësisë. Përfaqësimi i studentëve në struktura vendimmarrëse dhe monitoruese është një tjetër tregues pozitiv i përfshirjes së gjerë në këtë proces. <i>Referencat:</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Përmbajtja dokumentare dhe praktikat e përshkruara tregojnë se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit në Informatikë Biznesi janë të përfshira njësia bazë (Departamenti), njësia kryesore (Fakulteti), si dhe aktorë të tjerë relevantë si stafi akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët. Pjesëmarrja aktive e këtyre grupeve në analizat periodike, diskutimet dhe marrjen e vendimeve përmirësuese tregon për një kulturë të konsoliduar të përfshirjes dhe bashkëpunimit institucional. Përfaqësimi i studentëve në struktura përkatëse vlerësohet si një element i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. <i>Referencat:</i> <i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga takimet dhe vizitat në ishtitucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar vërehet përfshirja e rregullt dhe aktive e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke respektuar parimet e integritetit akademik. Vendimmarrja dhe vlerësimet zhvillohen në mënyrë të hapur dhe transparente, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, pa dallim roli apo statusi. Përfaqësimi i studentëve dhe i personelit në struktura të ndryshme siguron që zërat e tyre të dëgjohen dhe të përfshihen në proceset përmirësuese, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i>

	<i>Takimet dhe vizitat në institucion</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Fakulteti dhe Departamenti përfshijnë në mënyrë periodike bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit. Këta ekspertë, të cilët vijnë nga fusha akademike, tregu i punës apo institucionet partnere, kontribuojnë me ekspertizën e tyre për të garantuar që programet janë në përputhje me standardet profesionale dhe nevojat aktuale të tregut. Pjesëmarrja e tyre ndihmon në identifikimin e praktikave të mira dhe në ofrimin e rekomandimeve të vlefshme për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. <i>Referencat:</i> <i>RVB BA IB.pdf</i> <i>Takimet në institucion me stafin joefektiv dhe alumnin</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se përfshirja e aktorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit është e pranishme, por ende mund të zgjerohet dhe strukturohet më mirë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UNIKO ka ndërtuar një sistem të mirëorganizuar dhe të dokumentuar për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i cili është i përputhshëm me Planin Strategjik të Zhvillimit të institucionit dhe mbështetet në një kornizë të qartë rregullatore, përfshirë Statutin, Rregulloren e UNIKO-s, Manualin e Cilësisë dhe dokumentet e brendshme të fakulteteve. Politikat, strategjitë dhe proceset për cilësinë janë transparente, publike dhe të aksesueshme për studentët dhe palët e interesuara, përmes faqes zyrtare të universitetit. Gjithashtu, raporte të rregullta të vlerësimeve të brendshme përgatiten nga NJSBC dhe ruhen në arkiva institucionale, duke mundësuar një

	qasje të vazhdueshme ndaj përmirësimit cilësor dhe krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.1 STATUTI I UNIVERSITETIT 'FAN S. NOLI'.pdf</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilesise se UNIKO.pdf</i> <i>Shtojca 1.2 RREGULLORJA E UNIKO.pdf</i> <i>Aneksi 1.28 RREGULLORE E BRENDSHME E FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>Aneksi 1.25 PLANI I ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË.pdf</i> <i>https://unkorce.edu.al/studentet-informacioni-i-pergjithshem/</i> <i>Takimet në institucion me studentët dhe stafin akademik</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UNIKO ka ndërmarrë përpjekje të dukshme për të publikuar rezultatet e vlerësimeve të brendshme të cilësisë së programeve të studimit, duke respektuar lirinë akademike, etikën dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Relacionet Përmbledhëse të analizave të rezultateve nga pyetësorët e studentëve janë në faqen zyrtare të universitetit. <i>Referenca:</i> <i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i> <i>https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Relacioni-permbledhes-pyetesori-2023-1.pdf</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti i Menaxhimit në Fakultetin e Ekonomisë dhe UNIKO hartojnë dhe zbatojnë në mënyrë të rregullt plane veprimi që burojnë nga analizat e vlerësimeve të brendshme të cilësisë. Këto plane janë të strukturuar sipas mangësive dhe dobësive të evidentuara në raportet vjetore të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Para fillimit të çdo viti akademik, departamenti harton një plan vjetor veprimi, i cili miratohet nga Dekanati dhe përmban objektiva konkrete, masa për përmirësim, afate kohore dhe përcaktim të përgjegjësive për realizimin e tyre, duke synuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë së programeve të studimit. <i>Referenca:</i>

	<i>Aneksi 6.3 RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË EKONOMISË .pdf</i> <i>Aneksi 2.21 RAPORTET VJETORE TË VEPRIMTARISË TË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet në institucion FE-a dhe Departamenti i Menaxhimit realizojnë një proces të vazhdueshëm informimi dhe ndërgjegjësimi të stafit akademik, administrativ dhe studentëve mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Në kuadër të këtij procesi, takimet e Asamblesë së Fakultetit dhe ato të Departamentit shërbejnë si platforma kryesore për diskutim dhe përditësim mbi arritjet, rezultatet e vlerësimeve, si dhe identifikimin e nevojave për përmirësim. Këto veprimtari garantojnë monitorimin dhe vlerësimin efektiv të programeve të studimit dhe ndikimin pozitiv në përmirësimin e tyre në vijim. <i>Referenacat:</i> <i>RVB BA IB.pdf</i> <i>Takimet në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimet në institucion me dekanen dhe studentët ata organizonin rregullisht takime me qëllim informimin e studentëve dhe mbledhjen e opinionit të tyre lidhur me ndryshimet në programin e studimit, efektivitetin e metodave të mësimdhënies, metodat e kontrollit, si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Për më tepër, përdorimi i pyetësorëve studentor shërben jo vetëm për vlerësimin e programeve, por edhe për rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve mbi rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të vazhdueshëm të saj, duke kontribuar në zhvillimin afatgjatë të programeve të studimit. <i>Referenacat:</i> <i>Shtojca 1.17 RREGULLORJA E KËSHILLIT STUDENTOR.pdf</i> https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/05/Manual-per-studente-per-sistemin-Pitagora-fund.pdf
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UNIKO ka ngritur mekanizma të qëndrueshëm për organizimin e veprimtarive periodike me personelin akademik dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i>

	<i>Bashkëpunimi aktiv me Këshillin Studentor dhe përdorimi i pyetësorëve janë elementë të rëndësishëm që kontribuojnë në kultivimin e një kulture të fortë cilësie.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është në përputhje me misionin dhe vlerat institucionale, duke kontribuar në zhvillimin rajonal dhe kombëtar;
2. Ky program studimi ofrohet nga bashkëpunim midis dy departamenteve Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Informatikës. Fakulteti i Ekonomisë ka gjithashtu bashkëpunime ndërinstitutional me institucione të arsimit të lartë, ente publike dhe biznese private;
3. Staf i akademik është i kualifikuar dhe i përkushtuar, me procedura të qarta rekrutimi, trajnime dhe mbështetje për zhvillim profesional;
4. Programi ofrohet në mjedise komode dhe laboratorë, që mbështesin mësimdhënie teorike dhe praktike;
5. Universiteti ka sisteme menaxhimi dhe monitorimi të integruara për studentët, stafin dhe proceset akademike;
6. Studentët janë të përfshirë në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë;
7. QKA (Qendra e Karrierës dhe Alumni) mbështet punësimin dhe orientimin profesional të studentëve;

b. Pika të dobta:

1. Formatet e syllabuseve jo të standardizuara, sipas kërkesave ligjore (VKM Nr.41/2018) *[Standardi II.3 kriteri 4]*
2. Informacioni mbi programin dhe stafin akademik nuk është i disponueshëm në gjuhë të huaja (anglisht), duke kufizuar aksesin ndërkombëtar. *[Standardi IV.4 kriteri 6]*

3. Të dhënat statistikore për studentët dhe punësimin nuk janë gjithmonë të përditësuara dhe të harmonizuara në dokumentacion. *[Standardi V.4 kriteri 5]*

Rekomandime:

1. Standardizimi i syllabuseve sipas kërkesave ligjore (VKM Nr.41/2018), për të lehtësuar aksesin dhe orientimin e studentëve;
2. Publikimi i informacionit mbi programin dhe stafin akademik në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), për të rritur vizibilitetin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;
3. Përditësimi periodik i të dhënave statistikore mbi studentët dhe punësimin, duke i harmonizuar në të gjitha dokumentet institucionale;
4. Thellimi i analizave të performancës akademike dhe përdorimi më i plotë i feedback-ut nga studentët dhe alumni për përmirësimin e cilësisë;
5. Zgjerimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare për praktika, projekte kërkimore dhe mobilitete studentore;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Business Informatics"

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is aligned with the institutional mission and values, contributing to regional and national development;
2. This program is offered through collaboration between two departments: the Department of Management and the Department of Informatics. The Faculty of Economics also maintains inter-institutional collaborations with higher education institutions, public entities, and private businesses;
3. The academic staff is qualified and dedicated, with clear recruitment procedures, training, and support for professional development;
4. The program is delivered in comfortable environments and laboratories that support both theoretical and practical teaching;
5. The university has integrated management and monitoring systems for students, staff, and academic processes;
6. Students are involved in quality assessment and improvement processes;
7. The Career and Alumni Center supports student employment and career orientation;

b. Weaknesses:

1. Syllabi formats are not standardized according to legal requirements (Decision of Council of Ministers No. 41/2018). [*Standard II.3 Criterion 4*]
2. Information about the program and academic staff is not available in foreign languages (English), limiting international accessibility. [*Standard IV.4 Criterion 6*]
3. Statistical data on students and employment are not always updated and harmonized across documentation. [*Standard V.4 Criterion 5*]

Recommendation

1. Standardize syllabi according to legal requirements (VKM No. 41/2018) to facilitate student access and orientation.
2. Publish program and academic staff information in two languages (Albanian and English) to enhance visibility and international cooperation.
3. Periodically update statistical data on students and employment, ensuring harmonization across all institutional documents.
4. Deepen academic performance analyses and make fuller use of student and alumni feedback for quality improvement;
5. Expand international collaborations for internships, research projects, and student mobility;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Akron

[Signature]